

Roland Gjoxa

mëkati

BIBLIOTEKA

8SH-31

qj 89



roman

RSH-31
Gj 89

Roland Gjoza

MEKATI

Roman

56124

SHTEPJA BOTUESE "GLOB" 1994

piktor
ALUSH SHIMA

Shtypur në shtypshkronjën "Arbëria"
Formati: 70x100/32
Tirazhi 1500 kopje

Dhe në fëllim ishte fëmija. Ai s'dinte asgjë. Ishte e shtunë. Halla ndezi një qiri para ikonës së Shën Mërisë që mbante Jezuin në krahë, me atë vështrim të humbshëm, u gjunjezua dhe u lut.

Nëna shpoi gishtin me gjilpërë nga nxitimi. Teshat e babait dhe të fëmijës, sa herë ndërroheshin, do të arroheshin për një kohë të gjatë.

Babai s'kishte ardhur ende. Ai kishte kohë që merrej me shitjen e zogjve prej teleshiri me pupla të ngjyera me bojë të skaduar.

Pasdite, kur dielli po perëndonte, fëmija u nis me trenin veror prej dërrase. Lokomotiva e zezë që punonte me qymyrguri shfrynte si rinoceront dhe lëshonte shkëndija. Ato vëshonin luzmë vezulluese mbi kokat e njerëzve dhe sa hap e mbyll sytë fikeshin dhe lëshonin një pah të hollë hiri të zi.

Fëmija kishte frikë. Babai nxorri nga një çantë e madhe prej doku një varg me zogj teleshiri

te kapura me llastik dhe i tundi në ajër. Babai qeshte si fëmijë.

- Zogj të artë, 2 lekë copa.

Halla i ra në duar me pëllëmbë:

- Ç'bën more i paudhë, edhe këtu do të shesësh?

- Pse ç'ka? Më është bërë zakon...

- Si ç'ka more kokëqyp, ne s'shkojmë në panair po në qishë... Sofi... - iu drejtua nënës -
këtij i kanë lëvizur vidhat... Unë po zbres.

Dhe halla zbriti. Babai u bë meit. Nëna qau. Fëmija ishte mërzhitur me zogjtë dhe s'kuptonte asgjë. Ai kishte dy vjet që i shikonte ata zogj që babai i quante të artë dhe se kuptonte si gënjuheshin e i blinin njerëzit. Duke menduar kështu për gjithë ata njerëz të mashtruar që e rrethonin, me një ndjenjë superioriteti për veten, dëgjoji babanë që thërriste si i krisur.

- Ç'bën, mos, po unë për ty mbylla dyqanin që më tre, s'u lava e s'u rrojta nga nxitimi, dhe atë të shkretë ujë të hollë se kam bërë akoma... për ty, moj e lënë, kthehu...

- Jo, nuk kthehem... Ti mi prish gjithmonë gjërat... Edhe sot e bën pa qejf... të njoh unë ty.

- Aman kthehu... Për focë zakoni i nxoma

...o të shkretë zogj...

Babai e rrotulloi në ajër vargun me zog dhe e flaku mbi kokën e hallës para këmbëve të saj.

I degjuan bilbilat. Ra lisha e trenit. Fëmija numëronte zogjtë e thyer.

- Baba, ato u prishen të gjitha... - tha ai

- 2 tranga at kot, fare kot, për një kapriç...

Mia ka lene amanet e gjora nënë se ndryshe i bë mutim kësaj pune. Mëkat të mbyllësh më të dyqanin.

Halla u kthye. Mbante një zog te beshirte në dorë

- Si qenkan të këqinj. Vetëm kjo shpëtoi. E lodor. Do ta mbaj për shans.

Halla e kishte zakon të mbante për shans gjithfarë sendesh të çuditëshme që merrut si hyjnor në punë; pafta të rena këpuçesh, monedha metalike të gjetura në rrugë, bileta shfaqjesh, peshqja, vidha, gurë, lule të thara, flokë...

Nëna vazhdonte të qante.

- Pse qan ti? - i tha halla - Une vuaj, ti qan

allaçkë je moj e gjorë...

- Hallë, mos e shaj mamanë - tha djali i

trishë...

- Jo, shpirtkë nuk e shaj, por qan për hiçmosgjë. Të ka lindur mëma përjashta në dritë të hënës. Ju ka parë nata dhe hëna, ju ka parë frika.

- Jo, hallë, ajo më ka lindur në qilar, mbi qepë.

- Aq më keq, ju kanë parë minjtë.

- Mos - tha djali - se nëna vjell kur i kujton minjtë.

Nëna volli. Halla qeshi. Babai i merрте erë derrasave të vagonit.

- E ndieni? - tha ai. - Seç vjen një erë tymi i tharrtë i përzier me erën e urinës dhe të djersës.

Në mes të udhës treni ndaloi. Kishte marrë zjarr njëri nga vagonët. Në përshtjellimin dhe panikun që pasoi, djali e kuptoi vagëllimthi se asgjë s' ishte aq e pakuptueshme se ç' e kish pandehur. Zjarri, që përfshiu dhe dy vagona të tjerë, ndërsa njerëzit vraponin në fushën me tërfil dhe kuaj të penguar dhe me sanë përskaj, zhurmonte furishëm me kërcëllima, prafullima e brambullima të frikshme që të kujtonin natën me hënë dhe një grua që lind në fushën pa anë e fund dhe një fëmijë që s' e kupton këtë botë.

Të katër u ulën në tërfil dhe hëngrën

Lukë. Lokomotiva u nis vetëm me një fishëllimë që mbeti ende pezull mbi fushë, ndërsa ajo u zhduk.

- Çdo të bëjmë? - tha babai.

- Tersi je ti - tha halla. - Dhe tani mendon të kthehesh, po se thua.

- Jo, për këtë bukë, po dekurajohem shpejt.

- Si thua Sofi? - e pyeti halla.

- Ai është i sinqertë - pëshpëriti ajo me zë të dredhur sikur bëri faj.

- Si thua Bebi? - e pyeti fëmijën.

- Unë nuk di asgjë - tha fëmija.

U ngritën dhe ecën nëpër tërfil.

- Gjynah të shkelësh mbi tërfil - tha halla - të gjejmë shtegun e fushës... Ja një fener që lëkundet, atje...

Halla nxitoi duke thirrur:

- Gjarpëri, gjarpëri, ej, ç' më pickoi t'atje me bojë.

Feneri atje përtej mbi tërfilin që lëkundte lehtë nën hënë, nuk lëvizi më, ai mbeti ashtu pezull për një kohë gjersa halla thërriti sërish:

- Prit more i uruar, prit... gjarpëri...

Po feneri lëvizi dhe kërciti. U dëgjua një

zë:

- Ç' të pres, s'ju njoh fare...

Dhe feneri u lëkund sërish dhe filloi të ecte nëpër muzg me një mendjelehtësi prej vajguri me ujë që bën flakë të zbehtë e të ligur.

- O - vazhdoi feneri duke u tretur larg - i paska pickuar gjarpëri qytetarët...

- I mallkuar - briti halla. - S' të zëmë derën, O mosmirënjohës...

Feneri s'u pa më. Ata e gjetën, shtegun dhe u vunë në udhë.

- Ç' pate? - e pyeti babai - pse bëre si e lojtur?

- Doja të gjeja shtegun... Por ai qëlloi i lig... ìku, na la.

- Hallë, pse është keq të shkelësh mbi tërfil? - pyeti djali.

- Aty flenë xhindet... mos këput lule natën... Dhe kur do diçka bëj njëren derisa ta fitosh. Unë thërrisja që të më dëgjonte mbreti i xhindave e ta merrte vesh hallin tonë... Se është keq të zër nata duke shkelur mbi bimët... Ata natën dalin e shëtisin... Ti pa dashur, shpirtkë i shkel dhe bie sëmurë... Ndaj thirra e bëra ashtu... po mos ma vini re... Pastaj edhe ju mbaj me fjalë.

se ti i mbush brekët nga frika, t'u bëftë halla...
Ndërroje djalin, moj, se vjen erë.

- Ç' thua? u shqetësua nëna.

- Po, nënë, më ndërro dhe çorapet - tha
djali.

Kur mbërritën në xhade, djali e pyeti
hallën:

- Pse ishte mosmirënjohës ai burri me
fener?

- Ne shkojmë në qishë - tha halla - Ai s'ka
Zot.

- Pse s'ka Zot?

- Nuk beson. Ai sonte do të bjerë i sëmurë;
e kanë dënuar në emër të Jezuit. Ose do t'i
ngordhë lopa, ose do ta zërc dhimbja e kokës, e
veshëve ose e barkut...

- Më dhemb pak barku, hallë...

- E ke nga frika.

- Jo, nuk kam më frikë.

- Je ftohur. Sofi, jepi djalit një sapllake
çaj. Të gjitha i dëgjon Ai, ati ynë që është në qiell
dhe në qishën do ta gjejme dhe ty dhimbja do të
shkojë. Po shçëet, se po dëgjoj zëra.

Një grumbull i madh njerëzish kishte
mbushur karrocerinë e një makine, po shoferi

shante e përmendte vend e pa vend një veshkë që se kishte më.

- Zbrisni, se më zë policia, këndeje është rruga e kishës dhe ajo sonte ka dalë te kryqëzimet të bëjë kontroll... Unë jam gjysëm njeriu me një veshkë, kam shtatë fëmijë, do të më merrni në qafë.

Halla hapi portofolin.

- Sa do? - i tha.

- Jo, unë s'marr pare...

- Lëri nazet, po hap gojën, ose pëmdryshe do të llafosemi me një shofer tjetër, me dy veshka, që s'pyet për policinë dhe na shpie në vend si kokrra e mollës.

- O ç'më morët në qafë...

- Unë i jap një të puthur. - u dëgjua zëri i një femre, një zë i ngjirur i plogët dhe mbi karroceri u zgjat një trup i bëshëm me dy krahe që kërkuan dhe prekën, kokën e shoferit.

- O, jo, e kam të ndaluar nga mjeku... më bie të fikët.

Të gjithë qeshën. Shoferi mori zemër e sqaroi:

- Kështu më fluturoi njëra veshkë, nga timoni, pijet dhe femrat... tani s'kam më fuqi dhe

humbas toruan... ja, dhe tani po më merren mendtë... Më jep sa të duash - iu drejtua hallës, - ti - i tha asaj femrës që rrinte ende me krahë të varur dhe gjinj të shtypur mbi karroceri - eja brenda në kabinë. Ta dini, prej kësaj e keni, - shtoi ai me zë të vrazhdë.

- Ç'janë këto turpe, more, - u dëgjua zëri i hallës, por ndërkohë makina u tund e u shkund dhe njerëzit u përplasën, u ngjeshën e u shtypën me njeri-tjetrin si sardelet në kuti.

Pastaj, kur pritej që ajo karakatinë të vringëllinte e zhabëllinte si një grumbull hekurishtesh, ra në fashë e u platit për fare sikur ta kishin goditur e t'i kishin dalë rropullitë jashtë. Se ashtu vërtetë ndodhi, një vidhë e madhe ra me krismë e u rrokullis në xhade.

- A, ç'më gjeti - tha dikush - sonte që do të haja mish ariu për herë të parë në jetën time.

- Mua më presin kalamaqtë për bukë, kanë dalë në fushë e shikojnë hënën duke qarë - u dëgjua zëri i një burri që ishte gati t'ia shkrepëtë edhe ai të qarit.

- Kur do të mbërrijmë, o Zot - thirri halla.

- A është larg qisha? - pyeti ajo.

Menjëherë ra heshtje e qetësi, sikur

njerëzit t'i kishte zënë gjumi.

- Shëëët - bëri dikush - edhe ne atje shkojmë, po shëëët, pa e zënë me gojë...

Papritur makina nisi të lëkundej lehtë me një ritëm shtrati në çastin e një orgazme të nxituar; ajo nxirrte një zë prej azmatiku që të cingërriste nervat.

Dikush qeshi, një tjetër se përmbajti dot gazin e shfrenuar dhe bubulloi me një zë prej basi që të çorodiste fare.

- Pushoni ore ditëzinj - thirri halla - se është natë e shënuar!

Ra sërish qetësia, po lëkundjet ritmike të makinës vazhdonin me po atë turbullim e moskokçarje poshtëruese.

- Ja, ç'është në gjendje të bëjë njeriu me një veshkë! - tha halla me seriozitet.

Kaq u desh. që njerëzit të qeshnin, të shanin e të mallkonin.

- Hallë, pse tundet maqina? pyeti femija.

- Shoferi është me një veshkë dhe e merr ana, t'u bëftë halla... po t'i shiko lart yjet dhe hënën, atje janë engjëjt...

- Duken, hallë?

- Atje, do t'i rrëfejë halla

- Ku?

- Në qishë, brenda në murc, janë të vizatuar...

- Nuk fluturojnë?

- Nuk fluturojnë.

- Po pse?

- S'i lënë këta të mallkuar - pëshpëriti ajo - t'i shiko lart se kushedi dalin e fluturojnë në qiell. Vetëm njerëzit e pastër i shikojnë... - Ujje i pastër, shpirtë, do t'i shikosh...

- Po t'i shikoj hallë do të them dhe ty... Do të lutem për ty, për mamin, për babin...

Maqina qëndroi në vend pa lëvizur më. Ajo femra hamngjitëse doli nga kabina, zgjati trupin gjysmë lakuriq mbi karoceri dhe tha me një zë të qetë e të zvargur:

- Atij i ra të fikët... kush ka ujë?...

- Kurvë e ndyrë! - shau dikush - Qelbësirë!

- Kërmë! - u hakërrye një grua që mbante fort pas vetes një burrë të trashë me beretë.

- Ujë, se mbetëm këtu - tha kurva pa i bërë përshtypje asgjë.

Më në fund makina u nis. Kurva u ngjit në karroceri dhe qëlloi të zinte vend pranë hallës dhe fëmijës.

- Ç' bën moj e zezë - tha halla - Si s'hapet
gropa të të mbulojë! Ke mëmë, burrë, fëmijë?...

Kurva qeshi.

- Ç' më qesh mos rrospi, a e di ç' natë
është sonte?

- E di.

- Po ku vete?

- Në kishë.

- Edhe ti në qishë?

- Pse çuditësh, moj grua, kisha është për
mëkatarët.

Halla heshti.

Dikush ndezi një fije shkrepse që u snua
menjëherë. Një tjetër ndezi një fener që u lëkund
dhe kërciti, e ngriti lart për të parë më mirë, po në
drejtim të fenerit u ngritën shumë duar dhe e
mbuluan.

- Shuaje, shuaje të mallkuarën se na shikon
policia.

- Ku po shkojmë? - pyeti fëmija.

Po nuk mori përgjigje.

Kurva uluriu, shau si e xhindosur:

- Mos m'i gris brekët se i kam setapurë...

Fjalët e saj ranë si një bombë. Askush
nuk u ndie më, veç trapëllimës së makinës,

troshitjeve të saj nëpër gropat e rrugës dhe qenëve që i lehnin nga pas.

Burri me beretë bëri kryqin dhe belbëzoi:

- O Zot, na shpëto nga ndonjë e keqe...

Ç'natë! Ç'mjegull! Të vjen t'ia heqësh vetes...

- Shcëet, mos nëm se të dëgjon... u dëgjua zëri i atij që e kishte në majë të gjuhës fjalën shtë.

- M'i grisi që m'i grisi... ç'brekë... i kisha blerë në dyqanin me okazion.

- T'i paguaj.

- Ç'dreq zakoni! Po ç'pate që mi grise, o kafshë, sikur ta kisha moyllur me dryn, hajde de, po ato të shkreta qenë të holla si pëlhurë me fëmijë...

- T'i paguajë - përsëriti burri mbyturazi.

- E di unë sa paguani ju, mbaroni punë dhe ka të kam parë, hiqi duart, mos kafsho më, se ma bërë copë mishin...

- Të paguaj...

Feneri u ngrit lart, zbuloi një gji të madh e të lëshuar përpara me një tundim marra-nendës. Njeriu me fener, një skërfyll i gjatë, bubulloi si ari:

- O ç'breqet i mbarë, dilka e teproka për të gjithë, hyrrja-byrrja - u perkul mbi gji dhe e

kafshoi atë si një mollë.

- Thagma, thagma, o zot na shpëto -
ulëriti halla.

Kurva qëndronte si e ngrirë, e plogët, e
epshme, pa bërë as më të voglin veprim që të
mbulonte lakuriqsinë.

Burri me beretë u shkëput nga e shoqja
dhe iu afrua kurvës duke u dridhur. Ai diçka
donte t'i thoshte, po nuk mundte. Ai gji i madh e
i paturpshëm, përplot ngasje dhe kërcënim, më
tepër të ftonte të mëkatoje, se sa të ngjallte
ndjenjën e përçmimit.

Burri u përkul vrulltas dhe në këtë kohë
e shoqja uluriu sikur ta kishin pickuar.

Papritur bereta e qëlloi kurvën me
pëllëmbë dhe i tha:

- Zbrit nga makina s'ke punë me ne. Ti je
mëkati i lindur. Unë me time shoqe kemi 15 vjet
pa fëmijë. Zoti jep aty ku s'duhet dhe merr aty ku
duhet. Ti moj bushtër i mbush rrugët me kulishë
bastardë që do të bëhen nesër vrasësit tanë.

- Të zbresi - tha me urrejtje halla.

- Të zbresi - thirrën disa zëra me një
përbuzje të verbër.

Kurva i shtyu me forcë burrat që i

ngjisheshin pranë dhe u shfryu mu në fytyrë.

- Në qoftë se unë jam bushtra, ju jeni zagarët, të gjithë doni të kafshoni e të ndukni, ju a njoh mirë veset, sikur unë të zhvishem fare lakuriq e t'ju bëj një shenjë që të më ndiqni, ju do t'ju pushojë zemra nga tronditja...

Ti mezi pret ta bësh atë punë me mua - iu drejtua babait, - ti je një egoist i ndyrë me një shpirt sa një kuti shkrepseje, - iu gërmush skërfyellit me fener, ti tjetri, me gjithë brengën që ke, vdes për pulën e fqinjit, edhe po të jetë coflinë, të duket më e majme - i tha beretës - kurse ky i babëzitari krenohet me brekët e grave, i ruan ato si flamur dhe ia tregon kujt do si trofe gjeneralësh. A e dini që m'i ka marrë brekët dhe i ka futur në xhep? - e kishte fjalën për atë që donte ta paguante dhe kohë më parë, kish thënë se atë natë do të hante mish ariu për herë të parë në jetën e vet. - Ju të gjithë jeni mëkatarë si unë, po i mbuloni veset. Ndyrësira, unë nuk zbres nga makina vetëm pse ju a ka qefi ju, por, po të më teket, i them shoferit t'ju leri të gjithëve në mes të rrugës si bagëti, se ai prej meje ju mori, ju a tha edhe vetë.

Ç'u bëra unë këtyre horrave, që m'u

ngjeshën, m' u fërkuan e më kafshuan? U thashë gjë, i nxita, ju zhvesha para syve? Asnjë nga këto s' bëra, po ato janë mësuar t' i ngopin epshet edhe në një natë të mirë si kjo.

O Zot edhe unë dua të jem grua, të kem fëmijë!

Dhe kurva qau.

Qau në mes të rrapëllimës së makinës që gulçonte e shfrynte në rrugët e pashtuara, me grupa, në mes të një shpure njerëzish që e kishin fyer dhe poshtëruar sepse ajo ishte kurvë.

Fëmija pyeti:

- Hallë, pse qan?

- Qan njeriu shpirtkë, po ti mos iu afro se ajo ka zgjeben.

- Zgjeben? - pyeti fëmija me frikë.

- Të dalin puçra, kruhesh... shiko lart, bir, atje jetojnë engjëjt.

Fëmija ngriti kokën lart dhe pa hënën, yjet e panumërt dhe atë pafundësi errësire dhe fshëhtësie që i shkaktonte të dridhura.

Bereta thirri:

- Policia!

Feneri tha:

- Duket shumë feneri, jo, ta shuajmë fare,

po le t' i ulim flakën.

Shoferi nxorri kokën nga kabina dhe uluriti;

- Mos rrini në këmbë, uluni, se më morët në qafë...

Tre policë qëndronin ndanë xhadesë, hipur në kuaj të mëdhenj, që ju ndrinte qimja nën dritën e një llambe pesëqind qirinjsh të ngulur në një hu, veshur me mburojë, përkrenare, heshta e shtiza. Ata të shtinin frikën dhe djali i vogël, sapo i pa, e tundi hallën nga krahu:

- Engjëjt nuk po dalin moj hallo. Ç' janë këta?

- Shiko lart, shpirtkë, se këtu poshtë nuk ke ç' të shikosh.

- Po m' u këput koka, më dhembin sytë...

- Mos e harro fjalën e hallës se pastaj bie sëmurë, beso, lutu, mos e humb asnjëherë kurijon dhe ke për të parë engjëjt... Ata, kur shikojnë djem të mirë si ty, vijnë e të marrin...

- Jo, - u shtrëngua djali pas hallës duke u dridhur - nuk dua...

- Vetëm për një shëtitje nëpër yje, do të shpien në hënë të shohësh ca shpendë e ca kafshë që të çudisin shumë dhe kanë për të kthyer përsëri

tek unë.

E s'të pëlqen?

- Më nje kusht ama, po të na marrin të dyve.

- S'po ta prish qejfin, shpirtkë... oh, ç'shëtitje do të bëjmë!

- Shëëët, se po na kontrollojnë... - tha ai njeriu i shëtit duke hapur boçen e vet ku mbante ushqimet.

- Po kruhem, oh, sa po kruhem - tha djali dhe tregoi me kokë nga kurva. Halla e shtrëngoi pas vetes.

- Ku po shkoni? - pyeti përkrenarja me një dritë dore që u ndezi njerëzve në fytyrë.

- Asgjëkundi - tha feneri - Unë jam i verbër si Diogjeni.

- Unë shkoj të hajë mish ariu, thashë ta provoj sonte përderisa një mik më ftoi, po e shoh se nuk do ta shijoj dot...

- Unë po çoj bukë në shtëpi, po jam vonuar shumë dhe fëmijët kanë dalë të më presin në fushë dhe si fëmijë që janë qajnë nga uria dhe frika...

- Unë me gruan - tha bereta - udhëtojmë shpesh, jemi pa fëmijë...

Përkrenarja ndriçonte çdo fytyrë me dritën e dorës. Të gjithë përgjigjeshin sapo u verbonte sytë drita e fortë, pa e fshehur frikën e madhe që ndienin.

Drita ndriçoi fytyrën e djalit.

- Unë dua të shikoj engjëjt - tha ai, ndërsa drita s'qëndroi fare, po rrëshqiti te një fytyrë tjetër. Ajo u kthye sërish menjëherë dhe pllakosi mbi fytyrën e pafajshme të fëmijës.

- Ku do t'i shikosh engjëjt? - pyeti përkrenarja me një zë të egër pas hekurave.

- Në qiell.

- Asnjë nga ju nuk shkon në kishë? Asnjë?

Ai e lëvizi sërish dritën e dorës nëpër të gjitha fytyrat duke i zbuluar dikujt sytë një tjetri gojën, sytë e hapur jashtë mase të fëmijës, gjoksin gjysëm të zbuluar të kurvës që instiktivisht e me frikë lëvizi bluzën e shkopsitur mbi të, ndriçoi tërë karrocerinë, fencrin me një grimë dritë, që përpëlitej, bohçet e trastat e mbushura plot, një zog prej teleshiri të babait që kishte rënë në dysheme, gjithfarë imtësirash që kompromentonin disi qëndrimin e gjithsecilit.

- Ju e dini mirë që në kishë është i ndaluar reptësisht pelegrinazhi. Sot ka patur shumë

lëvizje dhe nga informatat, atje në kodër, te guri i shenjtë, siç thuhet, sonte mund të mbahet një meshë. Ju shkoni atje? Pse keni frikë ta pohoni se shkoni atje? Unë ju a shoh fytyrat, tani do t'ju shoh dokumentat, do t'ju kontrolloj bagazhet, se mos keni ndonjë ikonë, kryq, nuskë, e ku di unë çfarë tjetër, dhe fill prej këtu drejt e në rajonin e policisë. Sonte do ta ngrysni atje, në mes të pelegrinëve të tjerë që i janë nënshtruar procesit.

Në këtë kohë fëmija thirri:

- Hallo, një ëngjëll po fluturon në qiell, ja atje...

Të gjithë ngritën kokën dhe panë se si pas kodrave që mezi dukeshin në errësirë u shkëput dhe u tret një kometë.

Polici ngriti përkrenaren dhe qeshi.

- Kësaj i thua ëngjëll ti more piciruk?

- Po. Ai do të dalë prap; kështu thotë halla.

- Pse bën sikur s'më njeh - iu drejtua kurva policit.

- Jam me detyrë - tha ai dhe uli sërish përkrenaren, por kur i drejtoi dritën e dorës në fytyrë dhe ajo i buzëqeshi, ai tha:

- Ti je Marie?

- Unë jam.

- Eja me mua.

- Në polici?

- Si gjithmonë në polici.

- Ç' do të bëjmë, i dashur?

- Atë që kemi bërë gjithmonë.

- Atë që kemi bërë sikur kemi bërë gjithmonë?

- Mos provoko, jam në detyrë. Ku shkojnë këta njerëz?

- Asgjëndi. Janë mëkatarë. Kaq mjafton për t' i lënë të lirë.

- Unë jam në detyrë dhe policia s' merret me njerëz të lirë.

- Merrmë vetëm mua. Ç'kuaj të bukur! Do të më hipësh edhe mua në kalë?

- Zbrisni, zbrisni të gjithë nga makina! - urdhëroi polici.

Në dritën e llampës pesëqind qirinjshe të ngulur në hu, kurva dukej si princeshë në mes të gumbullit të rëgjuar dhe laraman të njerëzve që ngjiteshin e shtyheshin me instinktin e panikut.

Kurva tundte vithet e larta, ndërsa ecte në drejtim të kuajve që çukërmonin në vend, ndërsa era fërrmonte në drurët e natës.

- Ç'kuaj! - tha kurva sërish - ah, sa i dua kalorësit me uniforma prej metali. M'u neverit mishi. Shkojmë, djema - bëri ajo një gjest prej amazone dhe e la veten në duart e policit që e ngjiti në vithet e kalit.

- Lamtumirë o mëkatarë, lamtumirë, mos harroni se njeriu në fillim eci më këmbë e pastaj kalëroi me kuaj... Më mirë që s'i provuat kuajt sonte!

Polici me dritë dore ktheu fytyrën nga turma e njerëzve që kishin mbetur si të ngrirë dhe tha:

- Po pashë njeri që vete në kishë do ta ngul në hu!

Pas pak në rrugë mbeti vetëm ajo shpurë njerëzish fatkeqë me një fëmijë që vështronte tutje diku mbi kodra se mos shfaqej sërish engjëlli. Kuajt dhe makina kishin ikur me kohë, kurse mbi ta qëndronin yjet dhe hëna dhe mundësia për një mrekulli, por që gjithsesi nuk mund të ndodhte përderisa policia nuk e lejonte një gjë të tillë.

* * *

1.

- Unë do të iki, - tha shëti duke mbyllur grykën e bohçes.

- Ah, ç'më more në qafë moj motër - tha babai para çantës së hapur me zogj teleshiri - po vemi për dhjam qeni...

- Ti asnjëherë s'më ke dashur, Fjodor - tha halla. - Sapo u martove me Sofinë më sillje edhe mua dhurata, ato pasqyrlirat e tua, të gjitha të rreme, se s'ndjeje më, t'u bë zemra gur për motrën... po, po kështu është, pse më shikon me ata sy të shplarë sikur gjoja të vjen keq që s'të kuptojnë e të fyejnë pa të drejtë, sa herë kërkoj të më ndihmosh, ti merr pamjen më hipokrite në botë dhe thua me zë të dridhur, si s'hapet ajo gropë të të përpijë o Zot, se e ke amanet nga mëma, tamam si një detyrë, si një barrë që mezi e mban... Pty, jazëk të qoftë... Edhe kjo shushka rri dhe z'bën zë - iu drejtua nënës duke bërë lëvizje të hallakatura si e xhindosur.

Nëna s'u ndie, mbuloi fytyrën me duar.

Babai filloi të belbëzoi si i krisur pa iu kuptuar fjalët.

Feneri u nis duke thirrur:

- S'ju njoh fare, kush jeni ju?...

- Na more ti, i shkalluar, ku vete, apo do një gur pas qafe... oj, u bë i biri i botës të tallet me ne... Kur i thirra në fushë, këputi ca broçkulla që si zë as veshi i krraçit... Bjere more fenerin këtu se kemi një fëmijë që ka frikë nga nata... Ç'bëni ju burrat që më rini si hunj... Ti me beretë, a e di që po t'u lemeris gruaja, s'pjell fëmijë, po ti more derdimen që më qahesh për mish ariu e këtej nduk e kafshon mishin e asaj të zgjebosure... Asnjë s'do të kthehet mbrapsht... Asnjë s'do të kthehet mbrapsht, sonte të gjithë jemi nën mbrojtjen dhe hirin e shenjtë të Jezusit... ai do të shfaqet bashkë me apostujt në kodrat e qishës dhe do të na bëjë bekimin.

- Shëëët se na dëgjojnë - tha shëti.

- Kë shan ti moj - tha me zemërim bereta.

- Lere - tha babai - dëgjo veresie...

- Ç'do të thuash me këto fjalë? - u krekos bereta në sy të gruas së vet duke i marrë për dobësi fjalët dhe tonin e zbutur të babait.

- Si një mall që s'kushton dhe e ble gati

falas.

- Ku ta gjej një mall të tillë, ai të shijon...

- E pe, ajo i ka me bollëk, këtë desha të them.

- Me një fjalë ta le të më marrë nëpër këmbë dhe ti them faleminderit?...

- E po ç' t' i bësh, budallait, thonë pleqtë, hapi udhë...

- U, më marsh të keqen, dhe kush m' i thotë pa, ky, ky, torollaku që s' ka një farëz në kungull.

Disa qeshën. Feneri u tund dhe kërciti. Ai qeshi më shumë se të tjerët, u kthye dhe i dha fenerin hallës.

- Merre... vetëm pusho... se atje ku do të vemi duhen këmbë, jo llafe...

- Më jep mend ti mua? - e zbuti zërin halla disi e kënaqur.

- Jo, të jap fenerin. vetëm aman të nisemi... E dini që grindja ha koka njerëzish?

- E di more lum miku - tha babai - sonte do të provoj se ç' do të thotë të të hyjë huri...

Ah, ç' më mori në qafë...

- Të zëntë mallkimi i mëmës - tha halla.

- E pe që të shpëtova, moj e nxirë, se

kushedi ç'kish për të të ngjarë - i pëshpëriti babai.

- Dy duar për një kokë...

- Jo, jo, dy, katër, gjashtë, tetë duar për kokën tënde, se bëhemi katër ne të familjes.

- Jo, more, do të rriheshe edhe ti për mua, ë, po ti je lepur...Kur të zë gripi, thua po vdes dhe lë amanetet... Çdo vit le nga katër pesë herë amanete... Të thërras, ta dëgjojnë të gjithë se sa të vlen lëkura...

- Mos moj, mbylle atë fole grerash.

Papritur në fushëtirë u dëgjua një klithmë gruaje që u përsërit disa herë radhazi, në fillim ajo i hutoi dhe i tronditi njerëzit, por më vonë kur të gjithë e kuptuan mirëfilli se ç'po ndodhte atje në errësirën e pafund, me një hënë të ngrënë e të verdhë në qiell, u shndërruan sërish në një shpurë fatkeqsh me të cilët fati luan si t'i teket. Kurva dhe policët bënë qefin e tyre në tërfilin e butë të fushës duke e lënë të lirë orgazmën e tyre të fluturonte në formën e një mallkimi në atë cep të botës ku një grumbull njerëzish dhe një fëmijë donin të shikonin Jezuin dhe engjëllin mbi kodër.

- Shuaje fenerin - tha Shëti - Ata s'paskan ikur...

- Tre me një - tha babai - Ç'dosë, i mban

që të tre...

- Hyrrja, byrrja ... - ia bëri Feneri dhe fishkëlleu si i lajthitur...

- Kur s'e mbyta me këto duar - tha Bereta.

- T'i habe m... - tha Mishariu -

- Çfarë the? - u bë gati të niste sherrin Bereta.

- Ajo na shpëtoi dy herë, me shoferin dhe policët. Ishte ç' ishte, e keqja e saj, po për shpirt njeri e bujare si ajo, që jepte jetën po t'ia kërkoje, jo, jo s'gjen në këtë botë të vockël...

- Ç' do të thuash me këtë byrazer, se paskemi bërë gabim që s'jemi martuar me kurva?

- Jo, ato s'janë për burra si ty që s'kanë fuqi të lindin... Po ama janë të respektuara...

Bereta ia afërua Mishariut, po ai s'lëvizi nga vendi, madje i tha pa u turbulluar:

- Mos guxo se me një grusht, me të majtën gruaja jote mbetet vejushë. Po unë, or tuaf sonte isha ftuar të haja mish ariu... E di ç' do të thotë kjo?

- Mos thërrisni - tha Shëti - unë dëgjoj trok kuajsh, ata po vijnë... të ikim.

- Të ikim - tha halla - Pikërisht sonte e latë ju burrat të bënit luftë gjelash... ka të drejtë

kokëariu, kurva na bëri ndere, Zoti shikon, Zoti ndëshkon mosmirënjohësit...

- Jo kokëari - unë do të haja mish ariu, -
thashë - u zemërua me hallën Mishariu.

- Mos të të vijë keq, po kokën e ke ca të
madhe dhe me leshra të paqethura... Po mua
kështu më pëlqejnë burrat... se janë të fuqishëm
e na mbrojnë nga të papriturat e natës. Mos
harroni, kemi një fëmijë me vete dhe ai ka frikë
më shumë se ne. Nisemi, fëmijët e mi.

Gruaja iu afrua Beretës dhe i pëshpëriti te
veshi:

- Të gjithë qenkan të çmendur.

Ajo është më e re se unë dhe thotë fëmijët
e mi.

- Sonte do të rrah ndonjërin, se po më ha
dora e djathtë.

- Jo të lutem se ti ke dorë të rëndë...

- Kur të qëlloj ty, s'është gjë fare, të bie
me gjysmë fuqie se ta them këtu e ta lëmë këtu,
unë të lë në vend.

- E besoj, ti je i fortë për të rrahur...

- Pse vetëm për të rrahur?

- Ndoshta të tjerat janë me të dhënë, jo me
të thënë...

- Qënke e pakënaqur me mua?

- Mos më keqkupto, të lutem, unë të dua si e çmendur, dal të ta puth pak majën e veshit?...

“Vu”, “Vu” u dëgjua një zë që sa vinte e afrohej, një si hungërimë bishe që vraponte nëpër fushë.

Papritur ai u pasua nga një zë tjetër, zë gruaje i hakërryer që i shkriu gjakun shpurës të bërë meit nga tmerri. Ai që bënte vu, vu iu ngjit pemës dhe nisi të mbajë fjalime rusisht.

- Tavarish...

Një grua ç thyer në moshë, veshur me të zeza e kapi nga këmbët njeriun që thërriste sa i hante zëri dhe e rrëzoi përtokë. Ajo mbante një hu në duar dhe i binte me të. Njeriu që s'kuptohej se ç bënte, qau dhe ulëriti si ka i therur:

- Aman më shpëtoni - thërriste i rrahuri me një zë prej burri dyzetvjeçar

- Hiqjani nga duart asaj nopranës - nuk duroi halla.

Babai, Bereta e Mishariu bëne sikur i ndanë. Po kësntu bëri dhe Shëti duke belbëzuar si i hundakosur:

- Mos thërrisni se na piu e zeza...

- Më lini o lanetër, më lini ta vdes

qelbësirën se më nxorri bojën, më nxorri... Titi, eja në vete, këta janë doktorë, do të bëjnë gjilpërë.

Titi u çua në këmbë, si një top me dhjamë dhe u qeshi mu në fytyrë:

- Unë di të lahem vetë, të vishem vetë, të dhjes vetë, të shurros në brekë.

- Këtë të fundit e bën për të na gajasur...

Le të qeshim që t'i bëhet qejfi - tha gruaja e veshur me të zeza.

Të gjithë qeshën si budallenj.

- E kam djalë. M'u çmend në Rusi kur studionte për jurisprudencë...

- Marigo, kush e ka gjilpërën! - tha Titi.

- Të gjithë janë doktorë, po bëre zhurmë si në shtëpi do të çojmë me makinën e ambulancës në spital...

- Jo, jo - thirri Titi dhe iu afrua djalit.

- Po ti ç' bën? - e pyeti.

- Shikoj në qiell, se këtu në tokë, më thotë halla, nuk ke ç' shikon...

- Të bëjnë gjilpëra?...

- Kur ftohem nga bajamet, po unë qaj...

- Edhe unë qaj... pse shikon në qiell?

- Atje fluturojnë engjëj... Unë e pashë një sonte që u fsheh pas kodrës atje...

- Si janë engjëjt?

- Me krrahë dhe si prej ari, vetëtijnë...

Ata vijnë e të marrin kur ju pëlqen...

- Të bëjnë gjilpërë në qiell?

- Jo. Atje vetëm fluturon, nuk sëmuresh
asnjëherë dhe shikon gjëra shumë të bukura.

- Le të më marrin mua, thuaju, le të më
marrin mua, se Marigoja më rreh, doktorët më
bëjnë gjilpëra, të çmendurit më rrahin me grushta
dhe më bien me shqelma.

Po çfarë shikon në qiell?

- Engjëj, pra.

- O engjëj. Po çfarë shikon në qiell?

Djali iu shtrëngua hallës në krah.

- Hallo, ai qenka i çmendur.

- Pse tani e more vesh ti, moj shpirtkë? Ka
dorë, moj - e pyeti halla gruan me të zeza.

- Jo s' bën zarare, vetëm se thotë marrëzira.

- Ç'farë shikon në qiell? - e pyeti Tati.

- Engjëj.

- Çfarë shikon në qiell?

- Engjëj.

- Për mua s' ka këpucë, e kam këmbën 47.

Unë ha krimba.

Djali iu shtrëngua sërish hallës në krah.

- Ai ha krimba - i pëshpëriti.

- Ai thotë ç'i vjen në kokë, ti zbavitu me marrëzirat e tij, se nuk bën vërtetë ç' thotë me gojë.

Pas pak djali nisi të qeshte me Titin dhe e harroi fare engjëllin në qiell.

Babai uli pantallonat dhe u fsheh pas një ferre.

Afër dhe larg dëgjoheshin bulkthat. Tutje diku lehnin qentë.

- S'ka më rrugë - tha halla.

- S'ka - tha babai që andej nga ferra - Ah, të zeztë ne!

Djali u shtrëngua pas së ëmës.

- Tani u kujtove për mua? Shko te halla se me atë kënaqesh ti.

- Kam frikë - tha djali.

- Qëndroni - tha halla - nuk shikohet asgjë. Feneri. Ku është feneri?

- E ke ti në dorë - tha Feneri.

- Unë s'di, ndize.

- Nuk e ndez - tha Feneri - S'ju njoh fare...

Kush jeni ju...

- Po ti kush je mëre qyqar?

- Diogjeni.

- Diogjen, ndiz fenerin se mora një gur dhe ta këputa pas qafe? Oj, s'pyet fare burri se kanë frikë njerëzia, dridhen e u shpëton në brekë. se helbete natë është, e ku i dihet... Pastaj mendon për fëmijën ti more ditëzi?

- S'kam më grua, s'kam fëmijë... jam vetëm, fillikat.

S'ju njoh fare... Kush jeni ju?

M'u kujtuan të gjithë, m'u kujtua ajo natë. Oh, ç'natë! Oh ç'natë!

Feneri ra përdhe, po s'u thye. Burri u shtri sa gjerë gjatë dhe e zuri sëmundja e tokës. Ai përpëlitej, shkumëzonte, gjëmonte mbytur e humbshëm aty në errësirë, dëshpërimisht i shkëputur nga bota e të gjallëve, si ai njeriu buzë varrit, në grahmat e fundit...

- Nxirrjani gjuhën! - thirri babai pas fërrës.

- Kush t'ia nxjerri, të vdekurit? - thirri halla.

Nxirrjani more derdimenë...

Por askush nuk lëvizi sikur të kishin ngrirë në këmbë.

Titi u rrëzua pranë epileptikut dhe ia nxorri gjuhën e përgjakur sa hap e mbyll sytë.

- Po ky qënka xhevahir djalë - tha halla.

- Ai bën çudira, po me raste - tha gruaja
me të zeza.

- Ujë - tha halla.

- Ujë - tha dhe babai.

- Po ti që përgjigjesh vend e pa vend mos
je gjë kaps?

- Ç'kaps moj e zezë me bojë, bark, po
pëlças.

- Pëlçit, që të shpëtosh... Kot sa të morëm
me vete... S'je për gjë, mos të të vijë keq...

- Mos më çaj kokën, unë po vuaj, ti dërr,
dërr...

- Të ecim - tha halla - Mbajeni Fenerin.

Dhe pëshpëriti me frikë:

- Tamam si nata që kaloi Jezuri para se ta
mbërthenin - pastaj klithi e u hodh përpjetë se i ra
këmba në një gropë me ujë - Jam e mallkuar - u
grind halla - s'më vete mbarë për asgjë. Ky është
tersi - tregoi ajo babanë që po dilte nga ferra dhe
po mbërthente pantallonat.

- Mos nëm - tha babai.

Këndoi kukuvajka.

- Shenjë e keqe, edhe kjo ishte mangui -
tha halla.

- Jo do prishet moti - tha nëna.

- Mbylle, s' di gjë ti - ia ktheu halla.

Diku pas një bregoreje dikush nisi te godiste mbi një teneqe. Në një si hangar populiti. gjysmë të rrënuar po shfaqej film. Bezja e bardhë plot me rudha dhe arna ku po projektohej filmi. lëvizte nga pak nga era e natës. Te hyrja pa qemer dhe portë qëndronte si hu një gjatovinë që mbante në dorë një shkop. Në brez i varej një teneqe e madhe. Ai dërdëlliste diçka që s'kuptohej dhe kur bënte pauza, i binte teneqesë me shkop. Tek afrohej shpura u dëgjua më qartë e më shkoqur se ç' tha gagaçi.

- Shpejt, se do...y...yllim de... derën. Dy le... lekë bi...bileta.

Në ekran projektohej një film dokumentar me ngjyra. Enver Hoxha mbante fjalime duke bërë gjeste energjike, ndërsa salla e kongreseve gjëmonte nga duartrokitjet dhe thirrjet historike. Fshatarët me shata e lopata në duar, me cigare e çibukë të ndezur qëndronin këmbëkryq në mes të hangarit dhe kur e kur duartrokitnin edhe vetë si me komandë. Të tjerë me torba e fëmijë të vegjël në krahë qëndronin në këmbë me fytyra të drobitura, përplot përhumbje dhe apati. Ata që duartrokisnin dhe ata që rrinin si vuv, kishin të

njëjtën shprehje në fytyrë, sikur mendonin më shumë për vogëlsira, që më tepër se çdo gjë, përbënin jetën e tyre të mjerë. Ç' do të ngjëronin për darkë, ku do t' i gjenin qumështin dhe vezët për fëmijët tani që këshilli ua kishte marrë bagëtisë dhe shpendët, dikush kruhej, një tjetër kthente kurrizin dhe bënte urinën në kashtë, zhurma e së cilës mbytej nga zëri i lartë i Enver Hoxhës.

Një djalosh i ri i shkelte syrin një vajze me fustan dhe pantallona, që dukej si kërcure e përcëlluar nga dobësia dhe dielli i fushës. Ajo i lëvizte gishtrinjtë, pa e vënë re njeri, dhe i tundte me një grimë buzëqeshjeje, gishtin e madh të dorës. Në atë gjysmë barangë bëheshin plot gjëra dhe s' bëhej asgjë.

Titin nuk e pa njeri kur hyri brenda dhe zuri me trupin e tij të rrumbullakët e kaba një pjesë të madhe të ekranit. Tani Enver Hoxhës i dukeshin njeri sy dhe njeri krah që tundej lart me kërcënim me gishtin tregues përpara sikur përbironte botën armike.

Enver Hoxha fliste për të ardhmen dhe socializmin fitimtar, me slogane që shpërmdaheshin në barangë si tym.

Titu mori pamje prej udhëheqësi dhe nisi

të mbante fjalime rusisht.

Marigoja u shkëput nga grupi i vogël i njerëzve që kishin ndaluar përpara hyrjs dhe vrapoi si e kandakosur përmes hangarit me një hundë dorë.

- Ah, m'u bëfsh kurban; m'u bëfsh o i shkalluar që ma nxive jetën, që më bëre të tëqajë përditë për së gjalli.

Mos ia vini re o njerëz të mirë, se ka shkarë nga studimet e shumta, po e kam bir dhe se bëj dot hasha.

Huri binte mbi trupin e dhjamosur të Titit si mbi brumin e ardhur në magje duke bërë hije të madhe në ekran. Titi ulërinte nga dhimbjet, por s'hiqte dorë nga deklaratimet me ton prej udhëheqësi të citateve rusisht. Disa fshatare qeshnin mbyturazi, ndërsa pjesa më e madhe s'hapetinte, madje ndonjeri ulërinte që ta hiqnin zvarrë prej andej atë budalla bashkë me plakën e marrë.

Halla iu drejtua gjatovinës me ton që t'hyrja e barangës.

- O shok, nga shkohet për në Shenavlasti.

Gjatovina hapi gojën, përpëliti gojë nën pas dhëmbëve, buzëve, qiellzës, por pa mundur

të nxirrtë dot asnjë fjalë. Nga sikleti bëri një shenjë me dorë sikur do të largonte një mushkonjë.

- Ç' thua more, se s'të marr vesh! - iu hakërrye halla - Ç'jemi ne, dele? Na tregoke dhe vathën zotrote, me atë dorë që na e paske si putër ariu.

- Të lu... lutem... mos... mos më of... ofen...ofendo - tha gjatovina më në fund dhe mori frymë thellë.

Halla iu kërcënua:

- Eja na shpjer në qishë, atë bëj ti, nuk e shikon që jemi dy gra me një fëmijë që duhej të kishte fjetur me kohë? Oj, s'tundet burri.

Babai s'ndihej. Shëti pëshpëriti "Kjo është e çmendur, përmend kishën".

Gjatovina iu përgjigj.

-- Nu... nuk vij!

Dhe tregoi gishtin e madh me thua si të shqiponjës të kalbur krejt.

- Kaq ta bë... bësh dhë...dhë... dhëmbin!
Dhe i ra më shkop teneqesë.

Halla u hodh përpjetë sikur ta kishin përcëlluar me hithra.

- Burrë i thua vetes more ditëzi, po kur të pyesin ç'punë bën, si u përgjigjesh, se i bie

teneqesë?

Gjatovina u përkul dhe zhyti gishtrinjtë në pluhur për të gjetur një gurë duke harruar që mbante në dorë një shkop.

Babai qeshi me të madhe sikur të hingëllinte një kalë. Halla hapi një kuletë të zezë dhe nxorri prej andej disa qindëshe. Gjatovina u qetësua menjëherë.

- Nu... nuk vij, kë... tu s'ka de... derë. Unë jam de... derë - dhe tregoi me shkop derën e barangës.

Halla rëmoi në kuletë dhe i zgjati një mijëshe, kartë të re që kërciste. Këtë herë ai u hodh përpjetë nga gëzimi duke zbuluar gjunjët e holla, të vrara e të liga dhe një palë pantallona mbi gjunjë, zhuli dhe zgjyra e të cilave binin në sy që larg.

E rërmbëu paranë duke zbardhur dhëmbët dhe thirri si i handaksur:

- Në rrjesht!

: Ehtë larg, more i rrjedhur?

- Jo...jo...po të lu... lutem, mos më of...of...f...endo.

- I mallkuar - tha halla - ne shkojmë në qishë për të gjetur prehje e rehati e ti na ndjell për

luftë... pthu, jazek të qoftë!

- Mos më of... ofendo, se ju lashë kë...
këtu.

- Të zë mallkimi i gruas dhe i fëmijës së vogël, more vesh?

Ky i shkretë qënka budalla, si paskan mbetur as dy farëza në atë kaplloqen si kungull - iu drejtua halla babait.

- Lere moj e shkalluar, se po na lë vërtetë, kë do të na gjesh pastaj për të na rrëfyer udhën? Apo s'është një natë që të kall datën.

- Mos nëm, është natë e mirë.

Rreshti që i gjatë, se njerëz të tjerë mbinin aty këtu në errësirë si fantazma dhe ngjisheshin pranë njeri-tjetrit si për të gjetur mbrojtje dhe ngushëllim. E pëshpërimat vinin valë-valë nga fundi të kreu duke shkaktuar drithma, se të gjithë ishin kapluar nga një ndjenjë e çoroditur çorjentimi dhe frike të thellë. Feneri me gjithë ndërhyrjet e vazhdueshme, nuk donte ta ndizte fenerin. Ai mezi ecte i rraskapitur nga kriza e epilepsisë, dhe kur e pyesnin për diçka, ai përgjigjej tjetër për tjetër duke përmendur shpesh një natë si ajo po që pati qenë e tmerrshme. Shëti s'ndihej fare, sikur të mos qe aty. Mishariu se

përmendte më darkën me miq. Njeriu që do t'i çonte bukë fëmijëve që qanin në fushë, nuk fliste më për ta, sikur t'i kishte harruar.

Fëmija shikonte qiellin. Titi ecte dorë për dorë me Marigonë. Babai, kur e kur fshihej pas ferrave. Sa herë dilte që andej, thoshte si me vete, "ç'kam ngrënë i ziu unë, ç'kam ngrënë" dhe përmendte duke lëvizur gishtrinjtë e dorës tërë ushqimet që kishte ngrënë atë ditë: "kukureci kishte shumë kripë, ai ma ka bërë. Ah, moj Soli, i ke hedhur dy herë kripë, dy grushta, obobo, i ziu unë, po ku e kishe mendjen më shushkë. Ah, vdiqa, jam ndyrë, vij erë... O Zot, mos m'i dëgjo fjalët, jam ca i lajthitur, gjuha më ka shkarë përjashta, asaj gruas sime i ka ngecur përbrenda, gëk s'bën edhe kur e nduk dhe e ngacmon...".

- Ç'dërdëllit - i tha halla - shko nga fundi, ç'më mi ngjitur pas bythëve të grave, je burrë apo ç'je. Oj, dërr, dërr burri, shko ndihmo ata nga fundi, se kush po thërret e ulurin nga frika... Jepu zemër bashkë me kokariun. Ku është ai?

- Kokariu i satëme - u dëgjua një zë i lodhur, i dëshpëruar nga mesi i rreshtit.

- Pse ju vjen keq, burrat duhet të rinë në fund... ku është ai me beretë që rrefen grushtin

vend e pa vend? Ku është more?

- Ç'ke me burrin tim ti, moj... O Zot.
Ç'grua!

- Ngjishu e fërkohu pas burrit ti, atë bëj,
po shkrepjsja s'ndez në akull...

- Më lini, më lini ta lë në vend me të
majtën time - thirri Bereta.

- Shëëët - fshikulloi zëri i përvajshëm i
Shëtit - mos harroni se ku shkojmë, atje s'ka as
sharje, as rrahje, as urrejtje po vetëm besim,
shpresë dhe dashuri.

Babai thirri nga fundi i rreshtit ku po
çapitej me mundim të madh e plot frikë.

- Shëëët! Mos bëni si galat. Tani përpara
s'ju gjen gjë, se ju mbron fryma e Zotit, ndërsa
pas, në fund fare, më keni mua, këtë mos e
harroni.

Fare afër në errësirë, u dëgjua e lehura e
një qeni.

- Qe... qentë i lë... lëshojnë natën! - klithi
gjatovina.

- U... unë... mbaj shko... shkop!

Babai nga frika shkoi e u kap pas një
paralitiku që uluriu nga dhimbja, po me aq vrull,
sa ai humbi drejtpeshimin dhe u përplas pas një

njeriu me lemëz të vazhdueshme, i cili shkau mbi një grua dhe kjo pas Titit që rrëzoi të tjerët. E fundit shkau e ra halla dhe të gjithë u rrokullisën sikur t'i tërhiqte njeri poshtë nëpër pllajë.

Gjatovina qeshte me të madhe dhe i binte me shkop teneqesë. U dëgjua një hungërrimë e mbytur, që u pasua nga një lehje qeni, ajo u ndie aq afër sa halla që mbuloi kokën me duar, thirri plot llahtar:

- O zot, o Shënmëri, na mbro!

Lehja e qenit u shndërrua papritur në të qeshur prej budallai.

Halla shau:

- A, m'u bëfsh kurban, ti qenke more, dërdimen? Ku është parë që budallenjtë të venë në lojë njerëz me mend në kokë? Dhe ku pa, m'u në udhë të qishës.

Fëmija s'e mbajti dot, e lëshoi në brekë. Ai qau nga frika dhe mbuloi sytë me duar.

Gjatovina i ra dhe dy herë të tjera teneqesë duke qeshur me të madhe dhe u zhduk në errësirë tatëpjetë pllajës.

Halla i uluriu:

- Po kjo pikë e zezë?! Na more, ku vete, kërko sa të duash; një mijë, dy mijë... një kopaçe

kokës!

- U... unë jam de... derë - u dëgjua larg zëri i gjatovinës.

Nga një pemë aty afër Titi nisi të mbante një fjalim rusisht.

Po dega u thye me krismë dhe ai u plas përtokë si një top me dhjamë.

Halla qeshi e para duke mbajtur brinjët me dorë. Dhe pas saj qeshën të gjithë edhe vetë Marigoja, me zëra të lartë sikur të harronin se për ku ishin nisur.

Fëmija qeshi vetëm kur pa se si gajasej Titi i çjerrë e i grisur, me një mollaqe lakuriq, e me gojën plot me dhe.

- Pushoni! - thirri halla papritur - Do të na dëgjojë Zoti. Mirë thotë Ungjilli që ne jemi mëkatarë të lindur. Ai qoftë si na duron. O Zot, mëshirona! Jo, s' bëjnë kështu as qentë, as derrat, as macet, as delet...

Ja dhe udhën e humbëm...

- Të kthehemi - u dëgjua zëri i një njeriu të drobitur e të mërzitur.

- Oj, kush je ti? - pyeti halla.

Po nuk mori përgjigje.

- Ç' të bëjmë! Të kthehemi! - u dëgjuan

disa zëra të dëshpëruar e të egër.

- Të kthehemi! - tha babai.

- Dua të fle - tha fëmija.

- Jemi pa fat - tha nëna.

Halla briti me të egër:

- Je vërtet pa fat që kur more atë burrë. Në vend që të na prijë e të bëhet copë gjersa të gjejmë atë të bekuar qishë, ankohet si foshnjë. Kush s'beson te Zoti, do ta pijë e zeza.

- Ti, - iu drejtua babait - do të mbetesh pa hallate.

Babai tha: _ Ç' ta dua jetën, pastaj?

- Ti, - iu drejtua halla nënës - s' do të lindësh më dhe do ta tradhëtosh, të gjorin, do t' i vësh bri. Ti - iu ndërsye djalit - do të bësh gjithë jetën shurrën në krevat, do vjellësh e do sëmuresh, do ta bëjnë plagë bythën nga gjilpërat. Kthehuni po të doni, dhe mos besoni te Zoti, po ta dini, keni për ta pësuar. Ah, të mjerët ju, ç' do t' ju gjejë!

Halla e kishte humbur torruan, ajo thërriste e truante në errësirën e paskajshme, lëvizte duar e këmbë si ai njeriu i dëshpëruar nga alternativat, që hem do e hem s' do të ndodhë vërtetë ajo që e thotë me fjalë. Nëna villte e i binte alivan nga minjtë, ndërsa halla e humbte vetëdijen

kur shikonte gjak. Ajo s'kishte zemër për urrejtjen.

- Nuk thashë të ktheheshim për fare - tha babai me ton të zbutur - po të gjenim ndonjë udhërrëfyes tjetër që të vazhdonim të ecnim, po jo më tym...

- Edhe unë kur thashë jemi pa fat - ndërhyri nëna - s'e kisha me të keq, për kokën e djalit.

- Unë jam lagur moj, hallë, nga frika e qenit, mbërdhij, dua të ndërrohem... - tha fëmija.

Halla i vuri djalit dorën mbi krye dhe i trazoi flokët e dendur kaçurrela.

- Veri një copë djalit te brekët dhe vritni mendjen si t'ia bëjmë.

* * *

2.

Djali i vogël ngrinte kokën lart për të parë engjëjt e tij, por qielli që mbushur me re dhe larg diku mbi det vetëtinte pa gjëmime.

- Unë e kam ditur rugën - tha Buka - kam qënë disa herë në kishë po sonte në këtë errësi

të mallkuar njeriu humbet dhe rrugën e shtëpisë së vet.

- Ne s' kemi qënë asnjëherë - tha Bereta.

- Hë me sot e hë me nesër kaluan vitet si pa u ndier - tha gruaja e tij.

- Ajo natë s' qe si kjo - tha Feneri - s' vinte era madrigonie si sonte, po një si afsh tymi e shkrumbi dhe dëgjoheshin ca si goditje nga larg. Oh, ç' natë qe ajo! O Zot më bëj t' i shikoj edhe njëherë... O, unë i verbëri që s' shoh më...

- Ç' flet ky? I verbër dhe ecën përbukur pa u penguar gjëkundi - tha Shëti.

- Kushedi si do ta ketë hallin, i gjori - pëshpëriti nëna - edhe im atë, ndjesë pastë, kur s' i ecnin punët, thoshte për veten. ah, unë qorri... vjen nga dëshpërimi i thellë...

- Unë kam bile - tha Titi dhe qeshi si pavodë.

- Ç' është bilja? - pyeti djali.

Titi e nxorri nga pantallonat dhe e tundi me dorë.

- O, turp, - tha djali - unë thashë se ishte gjë që haej.

Ashtu kam edhe unë, po fare të vogël.

- Pse se dije ti që quhej bile?

- Eshtë turp - tha djali - po të na dëgjojë halla, vjen doktori me gjilpërë.

- Doktori me gjilpërë? S'e dije ti që quhej bile?

- Ka dhe emra të tjerë - tha djali - Shiko lart se mos fluturojnë në qiell engjëjt.

- Po engjëjt kanë bile?

- Prit të mendohem. Engjëll e pashquar, engjëlli i shquar, i gjinisë mashkullore, ka - tha djali.

- Sa mirë, qënkas si ne, fluturojnë, kanë krimba e kanë këmbën 47.

U dëgjua një zë gruaje. Një zë i njohur, i ëmbël, ngacmues.

- Ku po shkoni? - pyeti ajo - andej është ferma e derrave.

- Erdhi zgjebja - tha halla - e ditka rrugën.

- Ajo i di të gjitha rrugët po më mirë di atë rrugën nga kemi ardhur të gjithë duke ulëritur nga frika pa ditur se ç'mrekulli na priste - tha babai.

- Ka vetëm një mrekulli - tha halla - Zoti. Mendo për të, lutu për të, që të shpëtosh shpirtin o burmë i thartuar!

- Ejani pas meje dhe mos kini frikë nga

policia. Ata tre derrat flene atje ne fushë duke gërhitur me te madhe...

- Eja, moj, shejtanke - tha halla - na je qepur si rrodhe! Mos tu afro burrave, me jep dorën dhe vët përpara se u mbodhisem...

- Jo, dorën s' ta jap, po ju me ndiqni pas... oh, ç' natë! Tani fillon shiu dhe ne mëngjes do të çelin të gjithë trëndafilat. Ky vend ka shume trëndafila të zinj.

- Ç' thua moj, nuk duam shiun. Po trëndafila të bardhë ka?

- Sa të duash.

- Qënka vend me mbarësi. Ah, një trëndafil i bardhë në xhepin e vogël të një xhakete të zezë dopiopetë... Sa e dua të bardhën!

- Nuk këputen. Vyshken menjëherë. Janë vetëm për t' i parë. Dhe pastaj veç kur prishen vetiu...

- Ah, prishen vetiu, - tha halla dhe qau.

- Pse qan?

- Nuk di. Nga lodhja.

- Edhe unë qaj.

- M' u këput shpirti... po ti pse qan?

- O, unë i kam të gjitha arsyet për të qarë.

Aq arsye kam sa duhet të qaja gjithmonë... Ç' me

ka ndodhur mua, moj grua, as hasmit mos i ndodhtë...

- Vajzë - nxitoi të thoshte halla.

- E virgjër akoma? - qeshi kurva.

- Mos, ta dhashë me një kopaçe kokës, që...

Na bashkoi Zoti që s'bën përjashtime, po s'të kam as shoqe, as mikeshë... Nesër ku jemi parë, as më njeh, as të njoh... bishtëdredhur!...

- Hallë - tha djali - po kruhem...

- Ç'të mos kruhesh... zgjebja është sëmundje ngjitëse.

Kurva qeshte, kur e kur kukuriste si vajzë e re.

- Aman moj, - thirri babai - në kini perëndi, më prisni ca se vdiqa nga barku...

Ai uli pantallonat që ikishte bërë gati dhe mbushi natën me tollumbace që u çanë njera pas tjetrës.

- Ç'ke ngrënë more i Zi, ë, moj t'i ç'i ke gatuar... mos i ka rënë në pjatë ndonjë qime a ndonjë mizë... se ju gratë e sotme sa bëheni me fëmijë i ktheni kurrizin burrit.

- Jo moj, budallaçkë, jam ftohur... dridhem... nuk e di ç'kam... Oj një e dy dhe me

Sofinë e ka... I bie më qafë kot. Vjen dhe në qishë, gjoja... Hiç, një mut do të bëjë Zoti për ne, jemi me shenjë, grigjë e mbaruar që e çojnë për të therur... Pse vemi kot në kishë, ne jemi për kasaphanë...

- U, t'u thaftë gjuha, t'u thaftë... Mos nëm më, se të lamë aty në ferrë të të hanë qentë... Mbetsh pa hallate, ishalla, të dëboftë Sofia nga shtrati si një qen të gërbulur.

Babai qeshi me të madhe.

- Si e ka emrin ai? - pyeti kurva.

- Fjodor.

- Unë jam me Fjodorin. Ai tha të vërtetën.

- U, m'u bëfshi kurban, pse jeni ju të tillë.

kështu na qënka e tërë bota?

- Mbërritëm! - tha kurva - ja kisha.

Në errësirë përvijoheshin muret e një ngrchine të çuditshme, pa kulme e kumbanore. Kur u afruan, vunë re se ndodheshin para barangës ku qe shfaqur film në muzg. Tej nëpër natë shkëqenin dy tre drita të shtëpive të fshatit. Që atje tej vinin lehjet e qenve dhe më të rrallë bulurima e kaut apo pallma e gomarit.

- Ç'na bëre moj e lënë... ne prisnim të na çoje te dera e Zotit, ti na solle në haur... se haur

je dhe vetë...

Mori një hu dhe i hyri me të, ndërsa kurva therriste e ulurinte sikur t'i kishin ngulur thikën në zemër.

- Une do te bëj gropën sonte, mos më thënjën Evridikë, oj dhe ne trushkullurit i besuam një kurve... ajo di vetëm një rrugë... dhe në atë rrugë s'ka zot... O, mjerë ne!

Babai e shtyu me forcë hallën dhe mori në mbrojtje Marien.

- Ç'faj ka ajo moj budallaçkë, se mos e bëri me qëllim, se mos na mbante mëri de, e donte të na nxirrte inatin, a s'që ajo që na shpëtoi dy herë, pa ndonjë interes, gra të kësaj kategorie, u kërkon njerën faqe të japin dhe tjetrën, ukërkon buzën të japin dhe gushkën dhe syçkën...

- Pusht! - shpërtheu halla - Sofi, po të isha në vendin tënd, do ta ndaja në vend.

Bëje, më ke mua dëshmitare.

- Ai thotë lloj-lloj fjalësh moj hallë, po s'bën gjë...

- Ka dhëmbë, ai moj e nxire, ka, siç kanë zënë në mishin tënd, dinë te zënë dhe ne mish të huaj... Po ti je tyrfyçkë, i beson syshplarit, zagarit që mezi pret t'i dalë mbi udhë ndonjë

bushtrë që t' i tundë bishtin... Ja dhe kjo sonte po i tund bishtin. Atij po i dalin jargë moj nga.. shiko si dridhet, s' i vjen turp, s' i vjen...

- Kam ftohtë, ah, të kisha një zjarr... - tha babai dhe papritur vrapoi për të gjetur një vend të përshtatshëm duke ulur me ngut pantallonat e hallakatura.

Pastaj ra qetësia, një qetësi e çuditshme, përplot mllefe dhe pakënaqësi, lodhje e dëshpërimi, ndërsa shiu filloi të binte i shtruar mbi kashtën që zhurmonte mbytur duke ndjelle perhumbje dhe gjume.

U shtruan të hanin. Dhe ndërsa mllaceteshin me zhurmë, dëgjuan zhurmën e bezës në ajër. Bezja e bardhë kishte mbetur atë ditë në shtëpi me shiu. Babai grisi dhe një copë tjetër të kësaj kuptuar vetëm njerit, prej shpurës. Shëtitja e kësaj ishte një delikt.

- Atje shfaqen dokumentarë për atë... - tha ai... Neni 55.

- Ç'është neni 55? - pyeti djali i vogël.

- Agit prop.

Babai grisi sërish një copë bezë dhe lëshoi një ofshamë kënaqësie të thellë.

- Ç'bën more! - tha Shëti.

- Më ler, se rashë rehat, qënka copë e bute, pupulin. Deri tani e kam fshirë me lekë.

- Me lekë?

- Me qindëshe, rrëshqet ca, po fshihet mire.

E kam merak këtë të shkretë. Ah, të kisha një çikë parfum.

- I thua megjithë mend këto, apo tallesh?

- Unë s'tallem asnjëherë, vetëm se i marr gjërat lehtë.

- Agit prop - tha Shëti.

- Për fshirje b...?

- Jo për grisje pëlhure ku u shfaq filmi për atë...

- As që më vajti mendja... Ishte e mirë dhe e grisa... Jam gati ta çdëmtoj...

- Po aty u shfaq filmi...

- Ku e ke filmin, ajo është një beze e lagur nga shiu... Filmi ka shkuar, s'kemi punë me të... Kjo është një beze si të gjitha bezet, jam gati ta çdëmtoj... Sa kushton Zoti Agit prop?

- Mos u tall - ndërhyri Buka - Më kanë rrasur brenda vetëm se çohesha natën somnambul dhe i dhisja te dera një polici, një muti që m'i vinte vërdallë gras. Si somnambul më zunë të

gjitha nenet. I humba të gjitha, grua, fëmijët, jam vetëm fillikat.

- Nuk të presin fëmijët në fushë?

- Gënjeja për punë të kishës. Edhe Mishariu gënjejte. Të gjithë gënjenin.

- Kush ka parfum? - thirri babai.

- Unë - tha kurva.

- O, ç' erë - tha babai.

- Kamelje - tha kurva.

- Kamelje - përsëriti babai.

- Vërtet po e lyen? - tha Shëti.

- Ç' burrë! - tha kurva - Të gjithë vijnë erë djersë e spermë. Ata policët atje në fushë kundërmonin si këрма... Ç' burrë! - psherëtiu kurva.- Në këmbë, - uluriti halla - të gjithë në këmbë! - u çorr ajo - Bastardë! Sonte është nata e shenjtë dhe të gjithë luten me shpirt, kërkojnë bekimin e tij, ndërsa ju si qen rrugësh zhgërryheni nëpër plehra. Turp t'ju vijë, pthu! - pështyu ajo - Përjashta të gjithë, në shi, hajt, shpejt, shpejt, mos më shikoni ashtu pa pikë besimi shprese me ato sy të zbrazur që më shumë se Zotin, lusin gjumin, që më shumë se Jezuin shikojnë shtratin. Kush është më i fortë të dalë përpara e të na prijë, vetë Zoti i madh do të na e rrëfejë udhën e qishës.

Halla doli e para dhe sapo preku barin e fushës, es bota me nje farë gëzimi se shiu kishte pushuar dhe qielli shkëlqente nga yjet dhe hëna.

Ishte vërtetë një natë që të kujtonte fëmijërinë dhe ato përrallat e moçme me mistere që përherë dilnin për mirë. Nëpër ajrin e lehtë e të fresket kundërmonte era e merme e trëndafilave dhe e madrigonies. Ujrat fluskonin nëpër fushëtirë me ca zilka të lehta e gati të pandjeshme jo prej aji e uji, po prej argjendi të latuara si të punuar nga kordat e bilbilave të natës.

Feneri ndezi fenerin dhe doli në krye fare, disa hapa para njerëzve, ballë për ballë me ta. Ai ngriti fenerin lart dhe tha:

- Nuk e mbaj mend rrugën. Jam i verbër. Kujtesa më ka lënë, e ndjej veten të dermuar. Të gjithë qenkemi të verbër. Ja këtë desha të them.

- Une shikoj - tha halla

- Të gjithë jemi fatkeqë - tha Feneri, - u ktheu kurrizin njerëzve dhe u çapit përpara, sapak i perkulur, me fenerin që i tundej e i kërciste në doren e djathtë, me një flakez të luhatur.

3.

Jezusi mbante një torbe në dorë dhe një shkop në formën e kërrabës. Sytë e tij lëshonin një dritë të platintë si aureole dhe pikërisht nga sytë kuptohej që s' ishte njeri i zakonshëm.

- Ti je Jezusi - i tha i verbëri dhe u ul në gjunjë para tij.

- Ngrihu, o njeri - tha Jezusi dhe i dha të verbërit diçka nga torba e vet. Pak grure dhe sheqer të notitur.

- Po të jesh i uritur do të teprojë.

I verbëri hëngri dhe i teproi. Me atë që i mbeti mbushi një torbë plot.

- Ç' kërkon këtej në këto udhë të shkreta?

- Jam i verber! - pëshpëriti - Që nga ajo natë shikoj gjithëcka dhe nuk shikoj asgjë. Jam fill i vetëm.

- Ç' të ka ndodhur? - e pyeti Jezusi.

- Lexoja në dritën e kandilit diçka nga Platoni. Gruaja flinte. Fëmija flinin. Në mëngjes fëmijët e katundit më kishin zënë me gurë, të nxitur nga baballarët e tyre që pinin, vidhnin e

kurvëronin. Më dhimble tërë trupi. Lexoja dhe se kisha mendjen në vend. Më buçiste koka nga britmat dhe të sharat. Unë kisha një të metë, parashikoja shumë. I dija të gjitha horllëqet e tyre dhe s'lija rast pa ja u përmendur.

Nuk e merr me mend se sa të ligj janë njerëzit. Ata qajnë për të vdekurit si foshnje ndërsa vetë janë vrasës. Ata vetë janë shkaku dhe pasoja, po në jetë, herë sillen si shkaku, herë si pasoja. Asnjëherë nuk e arsyetojnë veten brenda të dy sferave, asnjëherë nuk pendohen dhe kurrë nuk e pandehin veten mëkatarë. Ata që e njohin mirë diçka, nga tahmaja kërkojnë diçka tjetër dhe në të gjitha e gjer në fund përdhunojnë, prishin dhe pak, fare pak ndreqin dhe këtë e bëjnë në emër të amoralitetit. Natyra nuk qe kjo, njeriu nuk qe ky, në kohrat pas Adamit mësova të bëj mëkate, por në kohrat pas Jezusit e ndjeva veten të penduar, u kaplova nga përdëllimi e bekimi i tij, ndërsa me kalimin e moteve u ndieva përherë e më tepër i vetmuar e i kërcënuar nga shanset e mija si njeri. Dikur unë shikoja retë dhe përshkoja pyjet. fjalët i këmbeja me gurët, me lumenjtë, me hënën e egërsirat. jetoja thjesht dhe bukuria shfaqej te minimumet. Pastaj erdhi komplikimi

në formën e një benese të ngushtë; përballë njerëzve që s'të duan, për arsyen e thjeshtë se asnjëri s'lëviz, mungojnë pyjet, retë, lumenjtë, egërsirat, mungon malli që e zë njeriun në vetmi dhe në këtë luftë të pashpallur me njeri-tjetrin në, nga dëshpërimi mendojmë për apokalipsin, rishfaqjen e Mesisë.

Mesi, ku je?

Më falni për dërdëllitjet e mija, po kam një ves të keq që lexoj shumë: Pra, atë natë po lexoja pa vëmendje Platonin. Një fanitje e bardhë lëbërëse depërtoi nga dritarja: kishte rënë bryma. Fushat zunë cipë. Pas pak tek frynte erë, gjithçka tingëlloi, sikur thyhej e thërmohej për fare diçka kristalorë. Ishte krejt e pamundur të mbaje libër. Po të të flihej s'flije më, po të ishte në gjumë, zgjoheshe, shumë gjëra ndodhnin vetiu, bie fjala qiejt e kaltër ndizeshin me një flakë të platitur ndërsa ujrata kumbonin si harmoniume. Që tamam si ai çasti kur njeriu më në fund në pajtim me të pakryerat e veta i nënshtrohet fatit nga dobësia; "Le të bëhet, pastaj të vdes. Gjithmonë para shkatërrimeve njeriu u beson më fort mrekullive që lindin nga paradokset, ngopet pa u ngopur për ta pritur atë që do të vijë nëpërmjet parandjenjave,

me një pandehmë të madhe të të pakryerave që bëhen simetri dhe përsosmëri ideale. Në këto raste njeriut i duket se është koha e shanseve të tij.

Do të ndodhë, mendon dhe i pëllqen të sfidojë atë që do të ndodhë.

Mora fenerin dhe u bëra gati të dilja.

- Ku po shkon! - tha gruaja - Babi të vijë edhe unë?

Jo, jo; flini është natë, ka rënë brymë dhe duket sikur ka aguar, po është natë dhe ftohtë.

Djali më ndezi fenerin. Djali kishte dy sy të thellë të qetë e të ëmbël. Më ndezi fenerin dhe e ngriti pak lart fitilin. Tjetri më qeshi me koken mbi jastëk dhe mbylli sytë e ljeti sërish. Gruaja u ngrit dhe më hodhi kraheve mushamanë. Ajo nuk tha asnjë fjalë se e dinte përse dilja përjashta. Nuk qe hera e parë që dija pa aguar në fushë, me fener nga pagjumësia për të menduar në qetësi e vetmi.

S'kisha bërë as dyqind metra në fushë kur u dëgjua një shungëllimë e largët dhe e nëndheshme pastaj toka u drodh, u shemb e u rropos, ndërsa unë shkava e radhë diku, përumbra e u treta dhe nuk di sa kohë kaloi gjersa u

përmenda nën një masë dheu. U ngrita ngadalë me fener të fikur në dorë.

Një parandjenjë e mënyrshme, një ndjenjë ankthi sfilitesc, një kujë e largët e thekshme, jashtë meje e brenda meje. Qielli që nxirë papritur, nga fushat ngruhej një tym i zi. Ç'kish ngjarë? Një tërmet i madh kishte shembur shtëpitë e fshatit, muret dhe çatia kishin zënë brenda gruan dhe fëmijët e mi. Unë e kisha humbur zakonin e natyrshëm të qenieve tokësore për të ulërirë nga dëshpërimi. Në tullat dhe djerrasat dergjeshin të shtypur e të prishur gruaja dhe dy djemtë e mi, që pak më parë më kishin përcjellë. S'do t'i kisha më. Kur u binda pas një memecelleku të gjatë dhe një nguroseje prej skeleti se s'do t'i kisha më, u shemba përdhe.

Pas disa ditëve kur endesha si i krisur fushave me fener në dorë dëgjova ca zëra brutalë që shaheshin e grindeshin në tavernë. Burrat e fshatit që kishin mbetur, vazhdonin të pinin, të shaheshin, të vidhnin e të kurvëronin. A kishte ndodhur Apokalipsi? Për mua, po. Unë kisha ndryshuar krejt dhe nuk do ta merrja veten më. Shikoja me sy, po shpirti më kish vdekur. Isha i verbër. Dhe si Diogjeni endesha me fener në

dorë, me atë fener të përjetshëm që ma ndezi djali me dorën e vet.

Apokalipsi kishte ndodhur, po njerëzit s'kishin ndryshuar.

Jezus, njerëzit nuk pyesin më për Apokalipsin, ata sërish do të dehen, do të rrihen, do të vjedhin, e do të kurvërojnë. Fara njerëzore është prishur.

- Ç' do ti njeri i çuditshëm? - pyeti Jezusi.

- Të shikoj gruan dhe dy djemtë e mi.

- Ke për t'i parë.

Dhe Jezusi u zhduk.

I verbëri pa se si mbiu nga bari i fushëtirës një mjegullnajë dhe në mes te saj dalloi në fillim si siluetë dhe më pas si një familje të hutuar, gruan dhe dy djemtë e dashur. Fëmijët thirrën, baba! Ndërsa gruaja u tha me dashuri; shkoni përqaftoni babain tuaj. Fëmijët u nisën drejt të atit dhe ai rendi drejt tyre... Gruaja qeshte dhe stoliste me qirinj të ndezur një bredh krishtëlindjesh në fushë.

- Obobo ç' na gjeti! - tha halla. S'qe gjë dhe ky udhërrëfyes. I verbëri qe plasur përdhe dhe përpëlitej në grahmat e sëmundjes. Titi i nxorri gjuhën, halla i hodhi ujë. Kur u përmend

ai pa rreth vetes fytyra të tjera; të shtangura e të dërrmuara nga lodhja dhe me një fill zëri përshtëpëriti:

- Unë e pashë Jezuin, gruan... fëmijët, unë i pashë... Besova, besova... dhe i pashë... Unë s'kam besuar kurrë kaq shumë... Besoni... Për herë të parë i pashë kaq qartë dhe kaq afër, për herë të parë, pas kaq vjetësh... besoni...

- E dëgjoni! - tha halla - ai i pa.

- Ke për t'i parë, tha Jezusi dhe unë i pashë. - përshtëpëriti i verbëri.

- Ai i pa - përshtëpëriti halla. - Të vazhdojmë udhën. Jezusi u shfaq.

- Kjo është udha, ndiqeni - tha i verbëri.

- Do të bëhet mrekullia... besoni... Jezusi u zhduk aty... Jo, s'isha në ëndërr, unë i pashë ose parashikova atë që do të shihja. Do të bëhet, do të bëhet.

Të gjithë ata që ishin përkulur mbi të i përshtëpëriti një drithmë e fuqishme sikur të zbulonin një të fshehtë të shenjtë duke shkelur mbi një marrëveshje me qiellin që duhej respektuar.

- Më ngrini dhe më mbani, ju lutem, unë nuk kam fuqi t'u rrëfej udhën... po Jezusi u zhduk në këtë vend...

Halla e pyeti se ku pikërisht u shfaq Jezusi dhe i verbri ia tregoi, pastaj e pyeti për vendin ku u shfaqën gruaja dhe fëmijët dhe ai ia tregoi. Ajo tha se ato ishin vende të shenjta dhe duhet të linin diçka. Halla la para nën një gur dhe veprimin e saj e pasuan i verbëri, Bereta me të shoqen, njeriu me lemëz të vazhdueshme, Buka dhe Shëti.

Kur grupi i gjatë i njerëzve kapërceu bregoren, dy vetë iu afruan vendit dhe morën lekët e vëna nën gur.

Ata e arritën duke rendur shpurën e heshtur dhe thanë:

- E dimë ne rrugën. Jo këtej, po andej nga ana e detit. Kisha është ndërtuar mbi det.

- Keni qenë ndonjëherë? - pyeti halla.

- Jo njëherë, po qindra herë, e dimë edhe me sy mbyllur.

Ata ishin të veshur keq, të ndryrë, me leshra të palara e të pakrehura, kur flisnin në gojë ju mungonin mjaft dhëmbë dhe disa të tjerë i kishin të thyer.

- Shkoni përpara! - tha halla.

- Jo, duam një shpërblim. Kemi dy ditë pa vënë gjë në gojë. Na kapën, na rrasën në qeli, na

rrahën e torturuan për shkak të kishës. Policët na kërcënuan se do të na ndiqnin, prandaj s'ndaluan në asnjë vend për të lypur bukë.

* * *

4.

Pas bregores ishte lumi. Djemtë kërcyesh në barkë dhe thanë:

- Do të hipni një nga një, përndryshe do të përmbysset.

Ashtu u bë.

Kur arritën në mes të lumit, njëri nga djemtë nxorri thikën dhe i tha babait, që hipi pari:

- Paratë!

Babai nxorri nga bohçja zogjtë prej teleshiri.

- Këto i kam për t'i shitur. Ju betohem, kjo është pasuria ime.

E kontrolluan dhe i gjetën një kreher fildishi dhe një shishe me parfum.

- Hape gojën - i thanë.

Ai e hapi dhe ata zbuluan dy dhëmbë floriri. Nxorrën darën dhe i shkulën. Ai ulëriu nga dhimbja, po ata s'donin t'ia dinin. Hallës imorën kuletën. Kështu bënë dhe me të tjerët. Dhe pastaj pasi i çuan të gjithë në bregun matanë dhe u rrëmbyen sendet me vlerë, u zhdukën.

- Po tani? - pyeti halla - Kujemi?

Po askush nuk iu përgjigj.

- Mirë të na bëhet - thirri ajo.

- O Zot, as më shkante nëpër mend një turp i tillë!

Po ku jemi? Kush do të na tregojë udhën?

Babai dhe Bereta mbanin gojën me dorë dhe fshinin gjakun me shami. Kurva qeshte me vete. Fëmija shikonte në qiell, Titi dhiste në breg. Tre burrave u kishin marrë rrobat e reja dhe tani qëndronin vetëm me brekë. Dy gra kishin mbetur vetëm me sutjena, pa vëthë dhe varse. Ato qanin. Nënës i kishin marrë këpucët.

- Mos qani, - tha halla. - Jepini njeri-tjetrit ç' u ndodhet me vete, se nuk shkohet në kishë me brekë e me gjoks përjashta, hajt, mbulohuni, shpejt, se s'ju shikokam dot, dukeni tamam si dordolec me shpendëra.

- Oi i ziu unë, 4 karat, floriri i paster, unaza

e mëmës! - ankohej babai.

- M'i morën të gjitha paratë, m'i morën të gjitha paratë - më mirë të më kishin marrë jetën. Ç'më duhet mua kisha, po kur të kthehem në shtëpi, çdo të ha? Jo, kjo as që më shkonte nëpërmend, ë, si thoni, a mund të ndodhin gjëra të tilla? Mos jam në ëndërr? - Buka e pickoi fort veten dhe uluriti.

- T'u vijë turp për fjalët që thoni, e humbën pusullën, bandillët, i thoni vetes burra, pale. Ajo punë bitisi, e mori ferra uratën, të gjithë humbën diçka po kjo mund të jetë edhe prova që na vë Zoti përpara për të kuptuar zemrën tonë. Ja, unë humba paratë, po jo të gjitha, se ato të kushtueshmet munda t'i gëlltis... Unë s'vete në qishë vetëm me letra, qindëshe e mijëshe që im vëlla, kur ka keqfshin me to, me nder prapanicën...

- Ç' thua moj e lënë, i kishe marrë dhe ato me vete? Pu, pu ç'më gjeti me ty..

- I kam të mijat, bëj ç'të dua...

- Po unë t'i kam dhënë, moj ... se s'ma nxë goja t'a them... po mirë, ç'do të bësh tani kur t'i dhjesësh?

- Ç'të duhet ty more matuf, po kjo është nera e marrë dhe e fundit që vij në këtë qishë dhe...

dhe do ta djeg...

- Të plaçin sytë, të plaçin, nuk e shikon që po na dëgjojnë të gjithë gojëhapur... Ja, ky guaku që është gati të pëshpërisë shët - tha babai për Shëtin që nuk e donte veten kur fare rastësisht bëhej dëshmitar i skenave të rrezikshme.

- Unë s'kam dëgjuar gjë - tha ai dhe u largua.

- Po ç'ka gëlltitur? - pyeti Bereta.

- Një okllai - tha babai për Beretën që mbante qëndrim prej kapadaiu.

- Po pse e ka gëlltitur byrekun?

- Shëet, - i pëshpëriti gruaja Beretës - pse je kaq i pavëmendshëm, si s'e kupton që ai tallet me ty, ajo e pafytyra ka gëlltitur nga ato verdhushkat me gjel... Qenkan të deklasuar... pa, pa, me ç' njerëz që na poqi fati...

- Ç' do të bëjë me to?

- Do të blejë qofte.

- Byrekë me qofte...? S'kisha dëgjuar ndonjëherë...

- E gjora unë që mbaj shpresë se do të kem fëmijë me këtë njeri... O zemër, si nuk ja bën bam, që të shpëtoj njëherë e mirë.

- Po tani ç' do të bëhet me ne? - pyeti

hal!a.

Dikush po qante pranë saj. Me një gulç të thellë e të përmbajtur. Ishte fëmija.

- Ç'ke shpirtkë?

- Kam frikë.

- Po pse, xhan?

- Ju grindeni, shaheni, gati sa nuk rriheni me njëri-tjetrin. Unë kam frikë.

- Jo, jo kështu, shpirtkë. Si të kam thënë.

Shiko lart se në qiell do të fluturojnë engjëjt. Ata nuk duan asnjërin nga ne se jemi të prishur na është bërë sa një thërrime, shpirti na është tharë e nxirë nga vuajtjet... ata të duan ty se je më i miri, më i pastërti, më i bukuri. Dëgjo hallën ti, ngreji sytë lart se sonte është natë e mirë dhe engjëjt janë për ty...

* * *

5

Ishte vërtet një natë e çuditshme. Te besosh nuk është e lehtë. Beson dhe vdes nga një veze e prishur. Dashuron dhe e ndien veten të tradhetuar qysh në natën e parë. Shpreson, por fatrat janë për engjëjt që ti ende s'i ke parë. Ata

të gjithë provonin të njejtën gjendje, ndonëse përjetonin aventura të ndryshme.

Njeriu kujton se e bind veten për gjëra që s'kanë të bëjnë fare me bindjen. Njeriu me pandehmën e vet e përshkon jetën derisa vdes. Nëse Mesia do të shfaqej sërish dhe njeriu do të shikonte dhe për fatin e tij të mirë do të besonte, megjithë përpjekjet prej Abeli nga fundet e jetës do të ringjallehin me forcën e Satanit, Kainët, Barabat, Judat dhe Pilatët, se cirkuidi i historisë gjithmonë përsëritet.

Njeriut, nga dobësia, do t'i mungojë mrekullia. Por, ai, nga pandehma, me të cilën e përshkon jetën, do ta trillojë atë.

Të gjithë ata që çapiteshin drejt kishës tronditeshin nga rëndomësia e shprehjes dhe e gjestit të përditshëm që përsëritej pa asnjë farë ndjenjë pendese edhe atë natë të shenjtë.

Duke parë në qiell hënën dhe yjet, por duke mos pikasur ende engjëjt, që ai priste ta merrnin për një udhëtim në pafundësi, djali shkau e ra në humnerë. Askush s'e pa, as zhurmë nuk u ndie.

Halla u bë si e çmendur, ndërsa nënës i ra të fikët.

Kur nëna erdhi në vete, halla i tha:

- Mos bëj si e shkaluar se është natë e shenjtë, asgjë e keqe s'ka për të ngjarë...

- Po ata engjëjt, mos...

- Ç'engjëj moj, kujton se vijnë vërtetë engjëjt dhe i marrin fëmijët? Po sikur... po sikur... Dhe halla bëri kryqin. Ajo qau dhe shtoi përmes ngashërimit:

- Jo, jo ne s'bëhemi njerëz... jemi djaj me brirë... ja, e shikon, edhe unë s'besokam, po ç'të thashë moj korbë, se s'ka engjëj se ata janë një profkë? O Zot, mëshirë për evlatin tënd mëkatar... ai s'di ç'bën...

Kurva tërhiqte meshkujt poshtë në përrua dhe u jepej duke i pëshpëritur secilit në vesh.

- Do të shikoni Amerikën falas. Sonte jam e të gjithëve për të fundit herë. nesër, gjer në vdekje, do të jem vetëm e njërit. Në dashtë Zoti...

Kur ia bëri me shenjë babait dhe i nxorri njërin gji, të rumbullt e të bardhë, që ia tundi me dorë, ai rendi pas saj si i ndërkryer dhe udhës duke u kacavjerrë nëpër shkarrëzime hoqi pantallonat e brekët të llangosura me nevojë.

- O, o - ia bënte babai sikur të qe në grahmë.

- Ç'ke? - ia ktheu kurva.

- S'kam më zemër, po një minë me shpat.

Kjo e shkretë kështu rri ngrehur gjithmonë. Por sonte kur të pëlçasë kam frikë se do ta hedhë në erë gjithë botën.

- Mos bërtit se do të na dëgjojnë. Ti më pëlqen me ato që thua. Ke sy që të zhveshin lakuriq... Je mashkull...

- Kam faj? Zoti m'i dha, Zoti më dënon. Mos bëj, më thotë. Unë e shkel gjithmonë. Po si ty s'më kanë zënë sytë... hajde bythë hajde... dhe i ra me pëllëmbë.

Ajo qëndronte në këmbë, më e gjatë se ai, lakuriq, me flokë të hallakatura mbi supë e gjoks, me sytë të ndezur sikur digjeshin nga mijra flakë.

- Merr ujë në përrua dhe më shpëlaj e më fresko... Dhe më fërko, më fërko fort... A, e shkreta unë që s'rri dot pa erën e rëndë të mashullit...

- A, u, o - buluronte babai nga padurimi dhe epshi i zjarrtë.

- O Zot, më bëj të freskët si çdo grua që shkon me një burrë gjithë jetën. Të freskët, të butë e të mirë, që të kem fëmijë e të më duan. O Zot!

- Po të ishin të gjitha gratë të freskëta, burrat do të zinin shtratin nga ethet - tha babai. - Ju shtoftë, perëndia, ishalla.

Kurva qeshte.

Duke fërkuar me ujë përroi kurmin humngjitës të kurvës, kur e kur duke e pickuar, puthur e kalshuar në vendet dhe vijat përvëluese që fërgëllonin nga epshi, babai shkeli diçka të butë që rënkoj.

Ishte djali.

Në fillim u tremb, por u qetësua menjëherë kur pikasi se aikishte humbur vetëdijen.

Në një rrethanë tjetër ndoshta do të kishte klithur dhe qarë nga gëzimi. Por seksi i saj i zbuluar në hënë, dy hapa më tej, ishte si molla në kopështin e Edenit. Të gjithë meshkujt janë Adamë. Të gjithë femrat janë Evë. Mëkati u përsërit në një rrethanë tjetër para syve që s' shikonin të një fëmije që kishte ende kohë për t' u bërë ose për të mos u bërë Adam.

Më vonë ai e ngjiti lart fëmijën duke e mbajtur në krahët e shtrirë e duke klithur nga gëzimi ndërsa nëna dhe halla e pritën si një shpëtimtar.

Fëmija erdhi në vete, po s' mbante mend

asgjë. I dhanë ujë për të pirë, byrek e kek për të ngrënë dhe kur të gjithë i kishte kapluar qetësia e ëmbël e përumbja dehëse, pas dëshpërimit dhe frikës së madhe që patën hequr, në qiell diçka u duk.

Fëmija u rrotullua rreth vetes i mahnitur dhe tha:

- Engjëjt!

Ai vrapoi.

Të gjithë e ndoqën pas. Udhës halla gjeti një patkua dhe e futi në bohçe. Ajo qeshi dhe u tha të tjerëve ta ndiqnin djalin se ai më në fund i kishte parë engjëjt në qiell.

- Do të shkojmë në qiell? - pyeti Bereta.

- Në qiell - iu përgjigj gruaja.

- Prandaj vij në njerëzit në kishë, mrekullitë ngjakan vërtetë, s' do ta harroj këtë natë.

- Më jep dorën të ngjitemi lart - tha gruaja.

Ai i dha dorën vërtetë.

Titi doli përpara fëmijës dhe uluriu si ka i therrur.

Ai i binte fort tokës me këmbët e zbathura dhe kërkonte t'i zinin të gjitha fiuturat e natës.

Ato sillnin mesazhe nga shkretëtirat ku ai ishte mbret i përjetshëm. Unë bëj luftë me grekët në Peloponez. Kam zënë rob të gjitha vajzat dhe i kam lënë me barrë.

Ai fliste e ulërinte duke vrapuar rreth vetes e fëmijës si i hazdisur.

- Më çoni atje, se vajzat kanë lindur qindra Tita të vegjël që do të shkojnë në Moskë për studime. Atje është dhe Tanja me sy të kaltër që më jepte çaj dhe biskota. Unë kam lënë me barrë të gjitha vajzat e Ruisë.

Marigoja e ndoqi me hu në dorë.

- Jak këtu o lanet se më nxive faqen me seje sorollop... Mos u hidh si halldup, mos thirrë sikur të jenë vënë qentë pas... Jak, rezil, kopuk, kur s' të merr ajo e nxirë, një orë e më parë, që të bie rehat e të shplodh kockat!

Halla tha:

- Mos mallko Marigo, e ke evlat...

- Aman, moj xhan, por kur do shpëtojë njëherë se vdiqa!

- Ai Zot e di!

- Jo! - uluriu fëmija. - Jo!

Të gjithë sikur ngrinë, panë nga njëri-tjetri dhe heshtën.

- Ç'ke të keqen, halla?

- Nuk shikoj më asgjë!

- Më mirë merre djalin dhe shko nga fundi, tani e vetëm shpirtke, na liq udhë se ti je e ngjell vetë...

Fëmija filloi të ecte ngadalë, duke parë në qiell i hutuar dhe i trembur dhe befasi, kur të gjithë e ndiqnin si të topitur, ai ngjiti gishtin lart dhe vrapoi.

U dëgjua një tingull këmbane e platitur si e harruar, si e rënë vetiu.

Fëmija pyeti hallën:

- Bie këmbana vetë?

- Eie - tha halla - Arritëm... O Zot... arritëm më në fund...

Dhe halla qau me zëra të thekshëm e me të qeshura të çuditëshme që ia ndërpriste kur e kur lemza.

- O Zot, o perëndi - u lut ajo - thashë se s'do të arrinim kurrë! Ç'ta fsheh, unë kërcurja, sapo dëgjova këmbanën vetëm atëherë u mbusha me shpresë e besim. S'kam besuar vërtetë. lutesha e falesha, po s'kam besuar vërtetë. S'kam çapur të vij gjer tek ti nga lodhja e sëmundjet... se vuaj nga mëlçia e reumatizma... Falmë o Zot, jam një

mëkatore që s'më ka vajtur mbarë për asgjë... për asgjë...

- Leri lotët, motër - e përqafoi babai dhe pak më vonë, ndërsa ajo po qetësohej, e vetëm psherëtinte si e penduar, ai i tha:

- Do të jap një këshillë, po ti mos u hidh përpjetë siç e ke zakon. Kur t'i dhjesësh ato napolonat, futi në kuletë e mos i nxirr më. Ruaji për ditë të zezë, se nuk i dihet... Kisha bën dhe pa to, se ka plot që kanë e që japin, po ti moj e uruar mbetesh fishek e s'ta qan hallin njeri se i more kur i more, po taji ç'të marrësh, opingat e Sheros?

- Fjodori mos më turpëro në sy të njëzisë... Ti ua ke vënë syrin me kohë atyre të shkretave, po s'ke s'i i merr se m'i ke dhuruar njëherë në sy të mëmës... Pty, sa i pafytyrë që je! Ja ka - taksur qishës!

- Do të venë dëm...

- Le të venë... Zoti i di dhe i shikon të gjitha...

- Hiqet dhe zengjine pale, dhe kush pa, kjo e nxirë me bojë që andron dhe brekët, se s'ka...

- Brekët do t'i androjë, gojën do ta thajë, por për Zotin s'do të kursejë asgjë. Ty do të

pllakosë mjerimi dhe sëmundja e ligë. Fjodor... do t'i bësh të gjitha në shtrat dhe Sofia do të lerë të zësh krimba. Ty të pret një e ardhme e zezë, tahmaqar i dreqit, shpirtkatran, mavri... më ler, vjen era përç dhe nevojë, largomu nga sytë, djall me brirë...

Nëpër natë u dukën dhe njerëz të tjerë, grupe-grupe që ngjiteshin në kodër. Një vaj i zvargur që u fashit, një psherëtimë e thellë, dikush tha: Besoni, besoni o njerëz deri në fund, se ai që e humb shpresën, e lenë fuqitë dhe vdes para se të hyjë në kishë.

Papritur u shfaq manastiri nën hënë, me një kumbanore e një sërë qiparisash të zinj, gjysmë i rrënuar.

Porta e madhe prej druri me qemcr të lashtë rridhte e pikonte, paftat prej hekuri shkëlqenin nga një dritë në oborr, një llambë e madhe pesëqind qirinjshe që lëkundej në erë me zhurmë monotone. Fëmija shikonte pellgjet në plloçat e oborrit që shushurin nga pikat e shiut, dritaret me hekura, pas të cilave digjeshin qirinjtë të madhësive të ndryshme me flakë të holla e të gjata me një dritë të marrtë, të zyrtë, kumbanoren e lartë e të heshtur, qiparizat me spikamë të errët,

hijet, dyert e mbyllura të kthinave prej dru arre të latuar e të fërkuar që shkëlqenin, shkallët prej guri me nga një shkorse për këmbët, pusin e lyster me gëlqere, litarin e trashë, kovën mbi të, që pikonte, barin midis plloçeve tek hepohej nën shi, dhe i dukej se mbi to rëndonte një pikëllim i madh që të ndrydhte zemrën.

"Na u afrua një njeri me raso deri në fund të këmbëve që m'u duk si mashkull i veshur me fustan të zi, shtatmadh, kokëjashtë, me fytyrë të gjerë e të mishtormë. Sa e pa, halla pëshpëriti: Urata, urata, dhe u drodh e tëra nga emocioni. Rrëmoi në kuletë dhe nxorri një monedhë.

Urata zgjati dorën kaba me një buzëqeshje të çiltër sikur të na njihte prej kohësh. Ai e kundërshtoi, po halla qau papritur dhe ai e përqafoi si atë.

- Janë shumë bijë, janë shumë... Mos u nxitoni... Kisha rron dhe pa to... në qoftë se jeni ngushtë...

- Po si morët uratë asgjë s'do të më vejë mbarë... Janë taksur për qishën...

- Faleminderit, bijë... ejani, dukeni shumë të lodhur nga rruga, do t'ju sjellim për të ngrënë e do t'ju japim shtroja për të fjetur.

Sahanët prej alumini të mbushur me pilaf dhe me mish kau të ftohtë i kthyem mbrapsht. Shtruam dyshekët e jorganët mbi dyshemënë me dërrasa të palatuara, po të lara si me finjë, plot me të çara e me vrima, vumë shandanin me qirinj gjysëm të tretur mbi pezulin e dritares me hekura, ndonëse në dhomë kishte dritë dhe halla papritur u ngjesh aty dhe qendroi ashtu për disa çaste sikur po përpiqej të sillte ndërmend diçka të harruar prej kohësh. Tërhoqa nënën nga fustani dhe e pyeta me zë të ulët për hallën. Lutet, tha ajo. Po pse: Shëëët mbylle!

Babai shtrydhte kuletën e hallës.

- Na, moj e nxirë, - i tha dhe i zgjati një tog me para, - kurseji ato të shkretat.

Halla ia mori.

Babai pëshpëriste: Qimet e kokës, o të zestë ne..

Halla u ndërrua, veshi një këmishë nate të bardhë me dantella, krehu flokët e gjatë gështenjë, me lëvizje të ngadalta, aq sa një çast i ngriu krëhëri në dorë, sytë iu bënë trishtë e iu veshën me një cipë të turbullt nga lotët. Ç'kishte ajo përse qante?

Pastaj e mblodhi veten, u kthye nga nëna

dhe e pyeti:

- Bien erë?

Nëna u çudit, ngriti pakës supet u përkul dhe i mori erë jorganit.

- Se dalloj dot.

Halla i pa me vëmendje, duke i prekur gjithnjë me dorë, ndolli me hundë, shfryu, dërsiu.

- S' u zë besë. Vijnë lloj-lloj njerëz.

- Duken si të lara.

- Ashtu duken, se është natë dhe na vjen gjumë.

Unë s' do të bie.

- Ua, po ç' do të bësh?

- Do ulem në prag dhe do të shikoj nga dritarja.

Me pëlqen shiu kur e shikoj nga flakët e qirinjve.

- Të paktën të shtronim.

- Lërimi llafet, bini flini! Të mbledhim ca veten e pastaj shkojmë në qishë e falemi.

U futem në shtroja, po mua s' më zuri gjumi.

U çova ngadalë dhe iu afrova hallës, që rrinte te pragu. Ajo më pa, zgjati dorën dhe më përkëdheli në lityrë. Më mori përdore dhe dolëm.

- Asgjë mos u thuaj atyre gjumashëve se ku vajtëm e ç' bëmë, ë shpirtkë? Dhe halla më puthi.

Jashtë ishte heshtje e qetësi. Pikonte nga majat e tjegullave. Qiparisat fërrmonin. Era fishkëllinte lehtë mbi ujrat e oborrit të kishës. Një xhuxh hipte mbi stol dhe ndiztë qirinjtë në shandanë. Ai bënte lëvizje të shpejta dhe pëshpëriste; ai do të vijë, ai do të vijë.

Një plakë e mbuluar me të zeza i tha hallës: Do të vi Jezui, moj bijë. Dhe bëri me dorë nga qielli.

- Do të vijë? - pyeti halla.

- Vjen çdo vit bashkë me apostujt.

Kodrat ndizen nga flakët, qielli hapet si rubin dhe vijnë ata me kaftanë prej ari e me qirinjtë të mëdhenj në duar.

- Ç' bëjnë - pyeti halla.

- O, ç' nuk bëjnë, qorin me sy, budallana me mend, shterpën me ferishte,... ç' nuk bëjnë... ç' nuk bëjnë...

Po nganjëherë nuk vijnë... mot përshembull... se këtu qe pëllëmbë e police, pëllëmbë e policë që qëllonin përpjetë dhe qeshnin si ca të shkalluar... U mblodhëm mot, një natë,

dy, tre, po ata s'erdhën, se të flamosurit s'na u ndanë si rrodhja, hiç s'na u ndanë...

Halla bleu qirinj, një ma dha mua, të kuqin, atë që kërkova vetë, dhe i ndezëm për shpirt të të vdekurve.

Pastaj ajo nxorri nga boçja një ikonë, e mbështeti në mur dhe u lut me lot në sy. Të gjithë luteshin të gjunjëzuar, me pëllëmbët e duarve të bashkuara përpara fytyrave me lot. Kur bënin kryq pëshpëritnin dhe rrufisnin hundët. Xhuxhi ndizte qirinjtë dhe përshpëriste: do të vijë, do të vijë... Njerëzia i afroheshin dhe i jepnin para. Ai i puthte në duar.

Hajati i kishës që mbushur plot me njerëz. Unë shkelja mbi njerëz po ata nuk ankoheshin. Halla kercente si pulat kur i ndjekin.

Dikush rënkonte, një tjetër fliste në gjumë, një grua e paralizuar i kishte hedhur duart në qafë burrit të saj zeshkan me mustaqe dhe po e puthte në buzë.

Një plakë dhe një plak mbaheshin te njeri-tjetri dhe flisnin duke zbuluar gojë të pa dhëmbë.

Një qorr, pa sy fare, me dy gropëza në oallë, fliste dhe gërrhiste sikur pëlliste një gomar.

Dikush s' kishte hundë. Një burrë ulur përtokë i kishte këmbët të prera gjer në rrëzë të kofshëve. Njeriu me lemëz të vazhdueshme s' flinte i qetë. Një grup ciganësh të heshtur me kanistra prej xunkthi e me djepe që i tundnin vështronin si me ankth me sytë e mëdhenj e të zinj. Një grua mbante shaminë në fytyrën përplot me puçrra e dregëza. Një burrë i ri me parkinson shtrëngonte në duar një trëndafil të kuq. Nga veshja, flokët e lëpira dhe shikimi që u hidhte dy grave me kofshë të zbuluara, dukej tip ashiku që digjej e përvëlohej më kot.

Halla ecte me këmishë nate, me qirinj e ikonë në dorë. Të gjithë kishin qirinj dhe ikona, pjesa më e madhe rrinte e gjunjësuar dhe pëshpëriste lutje.

Pastaj shkuam te guri, që unë s' e pashë dot, se atje kishte shumë njerëz.

- Ejani më vonë - tha xhuxhi - kur njerëzit të dalin në kodër, të presin ata... ata do të vijnë sonte... do të vijnë.

Halla i dha para. Ai i puthi dorën duke u ngritur në majë të gishtave.

- Kthehemi - tha halla - Ti do të flesh, shpirtkë, se je ligur nga udha.

- Jo, hallë, nuk me flihet.

Kur dolëm në oborr, Maria po qante para uratës i cili i mbante një rën dorë të hapur mbi kokë.

- Më dëgjo uratë, dua të rrëfhem.

Urata eci përpara dhe ajo e ndoqi pas. Në fund të koridorit u hap dera e një kthine dhe ata u futën brenda.

- Ah, m' u bëftë kurban! - tha halla dhe vuri veshin të përgjonte.

- Rrëfehu bijë! - tha urata.

Ajo pa nga vrima e çelësit. Edhe unë pashë nga vrima e çelësit Marien e gjunjëzuar para uratës që qëndronte në këmbë me dorën e shturrë mbi kokën e saj.

Halla më përzuri. Unë u futa në shtroje dhe fjeta. Pastaj se kush thirri. U dëgjuan ankime e sharje. Ndezëm dritën. Në çarçafë lëviznin çimkat. Pas pak ato u zhdukën. I bëmë stivë rrobat dhe u ulëm në dysheme.

- Skemi ç'presim më - tha halla - këtu s' flihet. Dhe të shikosh nga dritarja s' qenka gjë e këndëshme. Të vjen t' ia heqësh vetes.

- Shko, - i tha im atë - shko te guri dhe fati. Shpjegohu qartë, thuaji të gjitha, me besim

të plotë e me mend në kokë, e mos shaj si e ke zakon. Ai gur qan, qan vetiu. Kur preket nga fjalët që dëgjon, qan më shumë se zakonisht, kullon si dyllë, ke për të parë... Kjo është ora kur atje s'ka njeri, se flenë, e presin te kodrat dhe t'i mund të flasësh me zë se s'të dëgjon njeri - dil tani...

- Po ju?

- Ne për ty erdhëm... pas teje do të shkojmë atje me radhë të lutemi për ty...

- Edhe për veten tuaj.

- Edhe për veten tonë... po tonat janë gjëra të parëndësishme... ne për ty erdhëm...

- E di. Mos ma përsërit, se do të më duket që nuk keni ardhur për mua... Më shoqëro, kam frikë.

-Kur dolëm në hajat, dikush më kaloi përpara si hije. Ishte një prift me një qiri në dorë. Ai pëshpëriti diçka që se kuptova dhe mbylli dorën menjëherë kur halla i zgjati para, ca kartëra të reja që kërcitën... Iku duke u përkulur herë pas here në shenjë nderimi e përlësie derisa u zhduk në terrin e natës dhe atje tej mbeti vetëm flaka e qiriut, që dridhej e përpëlitej.

- Ç'bën, je në vete? Sa t'u japësh, aq të

marrin - tha babai.

- Shëëët, mos të dëgjojë njeri. Lemë rehat, se biem në mëkat...

- Po më vjen keq për ty, moj e zezë me bojë.

Atë kohë u dëgjua një ulurimë sikur dikujt t'i kishin ngulur thikën në zemër. Mbetëm si të shastisur, halla mblodhi duart dhe bëri kryq, nëna më mbërtheu nga krahu sa ndieva dhimbje, babai bëri sikur u nxeh për të fshehur frikën.

- Mos rrini si hunj në një vend, hajt, të shkojmë se pas pak zbardh...

Ulurima u përsërit më thekshëm, tejet e dhimbshme sikur një gruaje të gjorë t'i kishin rënë mbi kokë të gjitha fatkeqësitë e kësaj bote.

- Mos ia vini veshin - u dëgjua zëri i priftit me qiri në dorë - është Maria, një grua mëkatare, që kërkon të rrëfejë pendesë para Zotit. Ajo po pastron trupin e vet të njollosur dhe shpirtin e shitur, fill e vetme në mes të natës. E kanë lidhur në trungun e një rrapi dhe ajo rreh veten me shkop. Do ta zgjidhim vetëm ndaj të gdhirë. kështu urdhëroi urata, zonjë e nderuar.

Pëllëmba e priftit qe mbushur me dyllë. Qiriu qe gati në të mbaruar, flaka e vogël mezi

regëtitinte duke kërcëitur si në grahinë.

- Po pse imzot, - tha halla e tronditur - ç'ka bërë? Pse e lidhën?

- Asgjë. Ajo kërkoi vetë t'i nënshtrohej urdherit të tën Zot për të denuar satanë që i ka mbërthyer trupin dhe shpirtin. S'është hera e parë, moj zonjë e mirë kështu largohet satanai nga njeriu që kthen fytyrën nga Zoti dhe kërkon shpëtim prej tij.

- Po sikur të vdesë?

- Jo, përkundrazi do të shërohet. Këtu s'vdes njeri, bijë s'vdes, po vetëm ngjallet.

Qiriu u shua dhe lëshoi tym. prifti e shtypi me gishtin e madh të dorës tjetër. Pëllëmba e tij me dyll dhe me tym lëvizi gishtrinjtë e ngjitur dhe unë nuk e di pse mbylla sytë.

- Natën e mirë - tha prifti.

- Natën e mirë - tha halla. Babai i mbajti dorën.

- Ç'bën?! - ia ktheu ajo.

- Thashë se mos i jepje prapë.

- Mirë që ma kujtove, do të jap për Marien, për shërimin e saj.

- Je në vete? Si mund të shërohet një kurvë?

- Ajo ka hequr ne jetë, Fjodor, ti s' di asgjë, s'merr erë nga gratë, të gjitha kanë nga një histori, edhe ajo... unë e di... është për të qare vërtetë... T'i s'beson. Ti s'beson në shërimin nga Zoti. Kot sa te morem, ç'bera unë e zeza që kujtoja se do të qemë më të mbrojtura po të kishim një burrë me vete. Lutur dhe ti, o i zi, te guri i shenjtë, që të bëjë Zoti burrë... dhe pas teje të lutemi dhe ne të pafatat që të na bëjë gra me burrë. Oj, shpirtin e ka llagar, gojën farmak. S'i rri e shkreta, tamam si bythë e turtullit. Qimet e kokës, qimet e kokës, llomotit. Sikur ia rrëmbej nga xhepi i tij. Mbylle! Dhe hajt më ço te guri.

Babai e ndoqi pas si i rrahur. Në dorë mbante çantën me zogj te bashiri.

Hymë brenda në kishë. Po ajo pamje e rëndë. S'kisha parë asnjëherë njerëz më të trishtuar se ata. Ishte një lloj ferri provizor, që ekzistonte vetëm natën dhe vetëm njëherë për t'u përsëritur sërish njëlloj dhe ndryshe nga herët e tjera. Unë s'kisha për të ardhur më. Nuk e di, po s'kisha pse vija. Kësaj radhe më patën marrë ngaqë s'kishin ku të më linin.

Halla iu afrua një kthine me perde dhe qëndroi atje përjashta një copë herë të gjatë. Unë

vura veshin.

- Një vajzë, o zot, me syçka të kaltërta, më doçka topolake... - lutej gruaja e Beretës.

- Ç'të jetë, vajzë, djalë, ç'të jctë, një fëmijë normal, o perëndi, se po luajmë mendsh - e ndërpreu Bereta.

- Aman o Zot, se u bëmë 15 vjet që vuajmë...

Unë e di ç'heq se ky si di të gjitha, po vjehrra dhe farefisi i tij është betuar se do të më japin duart një ditë... Po ç'faj kam unë e gjora?

- Asnjë faj s'ke - tha Bereta - po nëna të shan vetëm për gjellët që i harron në zjarr.

- S'di gjë ti... Të gjitha ngjasin kur s'je në shtëpi.

- Pse s'më ke treguar?

- Ti je hajvan.

- Po ti ç'je?

- Fatkeqe.

- I lemë tani grindjet dhe i lutemi Zotit...

Ç'të jetë, edhe sakatë, o Zot!

- I mallkuar, ç'flet?

- Një fëmijë normal o Perëndi... desha të thosha, harrakate, e lëvizshme, djalli e marrtë.

Gruaja qan.

- S' di ç' flet...

- Bëjmë dhe ndonjë gabim në të shprehur, se helbete s'jemi prerë për profesorë, po për berberë, rruajmë e qethim dynjanë... Pse thashë ndonjë gjë të keqe?

Gruaja doli e para, pas e ndoqi Bereta me shprehjen e tuafit.

Halla u fut brenda. Pas perdes ajo nuk dukej dhe unë s'mund ta hapja, se babai bënte roje me fytyrën buçkane ku shprehej kotësia dhe keqardhja për dikë, me të cilin s'të lidhin më interesa të thella. Ajo u lut për Titin që t'i vinin mendtë, për Diogjenin që t'i shikonte sërish gruan dhe fëmijët, për të gjithë dhe harroi veten. Qau. Edhe unë s'i mbaja dot lotët. Pastaj rrëfeu historinë e Maries dhe u lut për të. Maria kishte pasur një burrë të bukur që e donte shumë. Nëna e tij nuk donte që ata të martoheshin. Kur Maria lindi një djalë të bukur si yll, vjehrra pagoi një shërbyese të maternitetit dhe ajo ia helmoi foshnjën. Maria u çmend. Pas disa viteve, kur u bë më mirë mori rrugët.

Pastaj halla tha për veten:

- Dua që burri të jetë me borsalinë, i veshur me kostum dopiopetë, ku sipër xhepit të

vogël të xhaqetës, t'i duket cepi i shamisë së bardhë me inicialet të thurura me fije ari. Të vijë era livando dhjetë metra larg, të mos mbajë syze miopi, se ata me syze më duken si maçokë, i kam përzënë dy meshkuj të tillë me syze. E dua me kepuccë të zeza me majë të veshura sefto. dua të flasë italisht e kur të flasë t'i duket sera e dhëmbëve të bardhë...

Halla zgjati dorën dhe la shumë para mbi kamaren në mur. Ajo nuk u mëdysh fare kur la atje dhe një nga ato monedhat e verdha. për të cilat babai e shante gjithmonë. Unë qesha. Babai qeshte. - Pika që s'i bie - tha.

Halla doli me shami te sytë.

- E, ç'u bë - e pyeti babai.

- Guri qau shumë... i bekuari... Fjodor, unë përmenda shumë profesione... po xhani ma do avokat... oh, sikur të jetë avokat.

- Do të bëhet, - tha babai.

Hyri nëna. Kur doli dukej e hutuar, sikur t'i ishin kujtuar papritur disa gjëra banale të jetës së përditshme, punët e rënda që e prisnin në shtëpi. Pastaj u fut babai.

Unë vura veshin.

- O Zot, - pëshpëriti ai - fale mëkatarin

tënd që të lutet me përgjërëm për atë të shkretë qyp me florinj. Kam kau kohë që gërmoj e rëmoj andej nga varri i Bamit dhe andej nga konaqet e tregëtarëve, që vdiqën burgjeve të zinjte, po sikam sjetur gjë. Një qyp dhe një qyp me florinj dhe ato gruan derdengë të doktorit të kafshëve, atë Hasimene që më mban qillota kur nder roba. Kam kohë që s'më zë dhembj gjë... Vetëm sonte me dashjen tënde i kenaqa dëshirat e mia. Po ti Marien mos e dëgjo o Zot, lëre siç është, se kur të kthehem, gjithmonë me dashjen tënde, ndoshta të japim edhe njëherë fëtilin e kandalit me vajin e sënatë dhe e mbajmë ndezur për një kohë të gjatë...

O Zot, mos ma shuaj kandilin dhe në treg... Mëshirë për mëkatarin tënd, O Zot, edhe kur bën ndonjë proçkë ku e shtyn qoftë largu.

Babai doli i ngazëllyer sikur ato që dëshironte, t'i kishte shijuar vërtetë.

Unë ulur ve nga dhimbja. Babai më tërhoqi nga veshi.

- Kopil, përgjoi babanë... ptuh! Falu dhe ti për shurrën që bën natën...

Dhe më shtyu urrenda. Nëna nxitoi të më fuste ca para në dorë.

- Lëri te kamarja - më tha.

Guri ishte i madh, në ngjyrë të verdhë dhe lotonte ngadalë sikur qante vërtet. Nuk ma mbante ta prekja. Më dukej se po ta prekja do vdisja në vend. Kamarja ishte mbi të në mur e mbushur me para. Ç'kundim i fortë që më pushtoi, më rrahu zemra si e çmendur e m'u kujtuan topat, akulloret, pullat e postës, biçikletat, e shumë gjëra të tjera që s'i kisha dhe i ëndërroja me sy hapur.

- Shpejt - më përshpëriti babai pas perdes - mos të ka zënë gjumi?

Te kamarja u duk një dorë me thonj të gjatë e të nxirë që i mori të gjitha paratë. Unë mbeta si i ngrirë. Një fytyrë e palarë m'u zgërdhi m'u në fytyrë. Pastaj me një biçak në dorë që ma drejtoi poshtë te pantallonat, më tha:

- Lekët që të dha mami, shpejt këtu, se ta preva bibilushin.

Hapa dorën e dirsur ku mbaja paratë dhe ai m'i rrëmbeu me vrull duke më gërvishur me thonjtë e paprerë.

Tjetri mbushi dy qese të mëdha plasmasi plot me pare.

- Një verdhushkë - tha i palari me biçak dhe e provoi me dhëmbë - Dëgjo ti miush - m'u

drejtua mua - po i tregove babë miushit dhe nënë miushes për ne, unë maçoku, fap, të ha me gjithë lecka.

Ai më nxorri gjuhën, më ra me shpullë në faqe dhe bashkë me atë tjetrin ikën duke qeshur. Ishin hajdutët që na kishin grabitur te barkat në lumë”.

* * *

6.

Dhe në fillim ishte fëmija. A ishte pagëzuar? Jo, s' ishte pagëzuar. Fëmija qau kur e zhveshën lakuriq. Uji që i ftohtë dhe ais' pushonte së qari.

- Mos shpirt - i foli halla duke e mbështjellë me çarçaf - mos, se do të shkalesh.

- Do të shkalloj , hallë? - u tremb djali

- Jo xhan i hallës, po këto kokotolet - dhe i preku rënjet mashkullore - do të bien dhe pastaj s'ke ç'i do, hidhja qenve t'i hanë në vend të kukurecit...

Po ty halla të ka kalë me samar...

Të merr të keqen ty, qoftë largu... Mos

qaj më, se atë do ai.

- Po ata i morën të gjitha paratë, më ranë mua me pëllëmbë në faqe dhe desh më therën me një thikë të ndryshkur... Ishin ata, hallë, ishin ata që na vodhën te lumi...

- Ç' morën, more korb?

- Lekët te kamarja.

Halla bëri kryqin.

Pas pagëzimit fëmija mbeti vetëm fillikat midis qirinjve që digjeshin në duart e njerëzve.

- Unë jam nuni yt! - i tha dikush dhe i zgjati një pako të lidhur me një sjongo të verdhë. Ai ishte një skërfyell me sy të kërcyer si të bretkosës që shoqërohej nga një grua e shëndoshë e cila buzëqeshte sikur po dilte në fotografi.

- Dhe unë jam nunaja - tha ajo.

Me një shpejtësi prej prestigjatori gishtërinjtë e saj të gjatë e fërgëllyes u valëvitën mbi pako si gjarpërinjtë e meduzës dhe nxorrën prej andej një kostum të kaltër dhe një palë këpucë të zeza.

Fëmija mbeti i hutuar dhe nuk reagoi fare, ai i shikonte ata nga poshtë lart me një ndjenjë të huaj për veten sikur papritur të qe bërë fëmijë i prindërve të panjohur.

Gruaja e kolme që buzëqeshte pa shkak e zhveshi menjëherë, e veshi dhe e mbathi sikur ai të qe një kukull, pastaj e puthi në të dyja faqet dhe i pëshpëriti:

- Biri im, ti je i njëzeti fëmijë që unë pagëzoj. Lutju perëndisë për mua që të më shërojë nga dhjamët dhe diabeti. Lutu gjithashtu, bir, për tim shoq që vuan nga mania e persekucionit.

Ata u zhdukën. Ai mbeti sërish vetëm i veshur dhe i mbathur si dhëndërr... Erdhi halla.

- Ka njerëz të mirë, shpirtkë. Ai si ka dorëzuar florinjte, ai burri i gjatë, nuni yt, dhe i harxhon, ja për të pagëzuar fëmijët e botës.

- Ç' do të thotë diabet?

- Sëmundje e sheqerit.

- Po mania e... mos do të thotë sëmundje e kripës?

- Aty afër. Ajo s'ha dot bakllavanë që ti e pëlqen aq shumë, ai s'ngjeron dot byrekun me gjizë e me vezë, për të cilën ti xhan vdes.

- Ç' do të thotë nun?

Halla u mendua.

- Ja po të pyes unë ty, ç' do të thotë hallë?

Djali ngriti supet.

- Po teze, shpirtkë?

Ai nuk foli.

- Do t' i llafos halla një herë tjetër, se s' kemi kohë tani...

- Dua atë baba dhe mama që kam, hallë, se ajo, nunja, më thoshte, biri im... po unë s' i kam gjë ata... s' i kam gjë... apo jo?

- I ke t' u bëftë halla, po babanë dhe mamanë s' t' i trazon njeri...

Djali filloi të qajë.

- Ç' bën kështu bir, përse qan?

Fëmija nuk iu përgjigj.

- Thuaj hallës, ç' ke.

- Kur do të vijë mëngjesi moj hallë, se po mërzitem... Hallë, shiten fëmijët?

Halla qeshi duke qarë. Ashtu iu duk fëmijës, se fytyra e saj u mbush me lot.

Atë çast ndodhi ajo që hallën do ta trishtonte vërtetë, ndërsa djalin do ta zbaviste në një farë mënyre.

Babai kishte hapur çantën e madhe dhe po shiste zogj teleshiri në kishë dyhapa larg krishtit të kryqëzuar.

Ai i ftonte njerëzit me qirinj dhe ikona në duar:

- Perëndia tha të bëhet dhe u bë. Këta janë

zogjtë e artë të kopështit të Edenit, që i kanë qëndruar mbi supe stërgjyshes sonë Evës dhe stërgjyshit tonë Adamit. Janë zogjtë e parë që u krijuan me frymën e Zotit dhe sjellin fat. Provojini o njerëz se do të mbeteni të kënaqur...

- Ç'bën ky ditëzi! - thirri halla.

More ti i paudhë, në qishën e Zotit e gjete të shesësh te beshirët e vjedhur nëpër shkolla? ... Pthu, jazëk të qoftë! Mos mirënjohës, mashtruës i pafe.

- Mos moj, mos, ule ztë zë pordhe se s'dëgjoj nga të dy veshët, më kanë zënë dyllë.. Budallaçkë, unë u dhashë duart të gjithave tu gërr-gërr. Këtu, në këtë vend të shenjtë edhe mu me qese t'u sheshës njerëzve në vend të hajmalive e blejnë si të babëzitur dhe të thonë, aman ore te lutem, ke më?... Ti je e krisur! Po ato që harxhove me të dyja duart, si do t'i vesh në vend? Me lutje? Lutu, ngjiru dhe mbaro...

- Mos, lanet, se do të ngre qishën me këmbë të të japin një dru të mirë, që kur ta kujtosh të të shpëtojë shurra në brekë.

- I jap gratis, moj budallaçkë, veresic.. po v's'i kupton shakatë...

- Fjodor, po s' mu zhduke nga sytë këtë

çast, do të bëj njërën, do të bëj.

Babai iku, si i thonë, me bisht ndër shalë,
pa u ndier.

- Më bëri me zemër i mallkuari! - u ankua halla. - Jo, s' do të bëhet gjë. Bota është prishur. Brumë i thartuar, ja ç' jemi!

Djali qeshte pa i kuptuar gjërat si halla.

- Shpëtofsht ti bir, se ne kemi djallin me brirë në shpirt. Jo, jo s' bëhemi, megjithëse i madhi Zot tha: të bëhet. Ishte nata e shejtanit kur lindi yt atë. S' dua t' ia shoh më sytë. Ai është i pafe. Duhet të largohet, thuaj, shko thuaj, se ia dhashë ulurimës dhe ngrita gjithë qishën në këmbë.

Djali nuk po qeshte më. Ai dukej i tronditur. Halla mbuloi fytyrën me duar.

- Mos shko. S' ke punë ti me të. Ti shpirtkë ke lindur natën e ëngjëjve. Do ta gjejë nga perëndia. ndëshkimi rëntë mbi të.

- Jo, hallë - tha djali. - Babai është i mirë.

- Ç' i mirë more, je i vogël s' kupton.

- Ai s' vodhi te kamarja. Babai gjithmonë shet ndonjë gjë. Pse keq është të shesësh hallë?

- Po jo këtu, se bie në mëkat dhe s' zënë lutjet tona. Ai është i pafe.

- Po ata që vodhën tek kamarja?

- Edhe ata që janë të pafe. Perëndia do t'i ndëshkojë rëndë. Hajdutët do t'i paralizojë, ata s' do të lëvizin dot as dorë, as këmbë, ndërsa ai karabushi, babai yt, do të mbetet pa gojë.

- Pa gojë?

- Memec - tha halla - Pa veshë.

- Pa veshë?

- Shurdh - tha halla.

- Vërtetë hallë?

- Ja, ke për ta parë, po s' u bë kështu si them unë.

- Jo.

- Do të bëhet!

- Unë s' të dua. Ti je e keqe.

Djali doli nga kisha.

Ai qau, mbuloi fytyrën me duar, tërhoqi hundët me gishtërinj dhe i fshiu pas rrobave të reja.

- E ke parë babanë tim? - pyeti ai një grua të pkeilluar që ishte ulur në gjunjë dhe lutej me sy të drejtuar në qiellin e zi të natës.

Gruaja nuk u përgjigj.

- Nëno, e ke parë babanë...?

O babai, ai vdiq në burg, e mbajtën tetë

muaj me ujë gjer në brez... Unë s' bëra fëmijë... Ç'je ti? Nga vjen? O Zot, mos është dhurata jote ky fëmijë i bukur si engjëll... eja bir... eja tek nëna jote - iu drejtua gruaja duke i zgjatur duart përpara me ca sy të çakërdisur plot ndriçim dhe lot drithërues.

Djali vrapoi përmes njerëzve duke u penguar nëpër gurët e oborrit.

- Baba - thirri ai - mama!

Nga një kamare në mur nxorri kokën Titit. Ai qeshi duke zbuluar një palë dhëmbë të rënë e të krimbur.

- Oh, oh, oh - ia bëri ai. Pastaj papritur klithi e uluriu sikur ta kishin goditur.

- Mos më laj moj, Marigo, se do ftohem. Jemi në Rusi moj budallaçkë, përjashta bie dëborë... Mos më vdis, ti po më vdes... hej ti muzhik i vogël më jep një gur t'i çaj kokën Marigosë - iu drejtua djalit që kishte ngrirë në këmbë.

- Të më hash m... - thirri Marigoja. - Nuk është ujë, si çdo ujë, po ujë ibekuar... S' ftohet njeri prej tij, vetëm gjallërohet dhe shërohet nga të ligat... ç' ma hëngre shpirtin shejtan duke u vërtitur si pordha nëpër brekë, po s' ndjenje urtë,

do ta bëj mishin me vurrata nga të ndukurat dhe të pickuarat... haram...

- Muzhik, më jep një gur... - thirri Titi.

Djali u ngrit në majë të gushtërinjve, po ishte i vogël dhe s'arrinte të shikonte dot nga kamarja se ç'bëhej brenda në kthinë.

- Më ka zhveshur lakuriq dhe po më rjep lëkurën... muzhik, aman, më jep një gur... t'ia çaj kokën kësaj shtrige...

- Kujt i thua shtrigë ti more i paudhë... nënës që të bëri kokën, që e lidhi jetën me ty, kërmë, dhe s'u martua kurrë më, po mbeti kërcure si ai vidhi në pyll që u shkrumbua e u nxi nga rrufeja e fatit të mallkuar? Na, haram! - dhe e qëlloi me diçka të fortë që e bëri Titin të hidhej përjetë e të ulurinte nga dhembja.

Djali u pikëllua.

- Marigo, mos e rrih Titin. Ai është shoku im.

- Më jep një gur...

- Mos e rrih, se do t'i jap një gur të të çajë kokën...

- Ik bir, ik shiko punën, se këtij të shkreti i kanë lëvizur vidhat... dhe i ka dalë mendja jashtë si flutur... Ik bir, se ky kështu e ka...

Pas pak Titu u qetësua. Nxorrikokën sërish në kamare dhe buzëqeshi.

- Po bie dëborë... Rusia ka shumë kisha... shumë priftërinj, shumë kryqe. Kur bie dëborë, vajzat bëhen me flatra dhe fluturojnë... Sa mirë është të jesh vajzë... Marigo, ç'jam unë?

- Evlat.

- Kur do të fluturoj?

- Ti ke fluturuar, bir.

Marigoja filloi të çante me zë. Ajo dëneste thellë dhe nga pikëllimi që u përhap nga kamarja, djalit iu duk se vërtetë binte dëborë dhe bënte shumë ftohtë... Jo, ai vendosi të mos ia jepte Titit gurin që i kërkoi se iu duk e kotë dhe e çuditëshme që Titi t'i çante kokën Marigosë që po çante.

Papritur, ai pa një tufë me flutura të bardha nate që po vërtiteshin rreth llampës së madhe. "Sa mendje po fluturokan sonte" - pëshpëriti. "Ku është flutura ime. Po sikur ta kapi njeri me dorë, po sikur të ngordhi?"

Djali u mërzi nga arsyetimi i vet dhe këmbët e çuan tek kthinat, nëpër korridorin e ngushtë, ku digjeshin përtokë qirinj të ndezur.

- Baba - thirri ai dhe hapi derën e parë.

I verbëri polutej para një ikone

- Baba, mama - thirri sërish dhe hapi derën e dytë.

Ata që s'lindnin kurrë, Bereta me gruan e vet ishin bërë njësh mbinjë shtrat të ngushtë prej dërrase të palatuar. Trupat e tyre lakuriq e tronditën fëmijën, i cili e mbylli shpejt derën që kërciti përvajshëm.

Djali vendosi të mos hapte më asnjë derë tjetër. Në fund të korridorit ishte një parmak mbi të cilin vezullonte një qiri. Ai u ul atje dhe mbuloi fytyrën me duar.

- Mos qaj - dëgjoji një zë të ëmbël. Kundruall tij ishte ulur një ëngjëll. Djali u hutua. Engjëlli ishte i vogël, me dy flatra të mëdha që i shkëlqenin nga drita.

- Ti kërkon nënën dhe babanë?

- Po.

- Nëna po ndihmon një plakë uloke, ndërsa babai yt, ai babloku i çuditshëm, po shet zogj te beshiri. Do të them dhe sa zogj i kanë mbetur? Dy. Eshtë njeriu më i lumtur i kësaj nate. Po ai nuk ka ëngjëll. Se ëngjëlli atë e ka lënë me kohë...

- Eshtë keq kur të lë ëngjëlli?

- S'ke më mbrojtje.

- Po ti kush je?

- Unë jam ëngjëlli yt.
- Ku rron ti?
- Lart në qiell.
- Po atje lart në qiell nuk duken shtëpitë,
rrugët, pemët...
- Atje janë, po syri i njerëzve nuk i shikon
dot...

Do të vish me mua?

- Jo.

- Eja.

- Jo, kërkoj nënën dhe babanë. Mos të
vijë keq, po unë nuk ndahem dot nga nëna dhe
babai. Sa i bukur qenke. Ti prek një çikë krahët?
O, sa të lëmuar. Po pse the se je ëngjëlli im?

- Çdo njeri ka ëngjëllin e vet. Këtu në
tokë është shumë mërzi, njerëzit vuajnë nga etja,
uria, sëmundjet. Ata ndiejnë dhimbje, gjithmonë
ndiejnë dhimbje, kjo është e padurueshme.
Njerëzit vriten me njëri-tjetrin, shahen, rrihen,
përbuzen, urrehen...

- Unë s' të kuptoj - i tha djali.

- Toka është e mallkuar - tha ëngjëlli.

- Kush e ka mallkuar?

- Vetë njerëzit. Po të vish me mua do të
kuptosh se sa keq jetohet në tokë. Unë nuk të lus

më. Si thua, do të vish?

- Jo, mua më pëlqen këtu. Se këtu kam nënën dhe babanë. Po ti ke nënë dhe baba? Ke pajtjetër. Pse s'ri këu me mua?

- Njerëzit do të më vrisnin sa të më shikonin.

- Pse?

- Nuk jam si ata. Ata janë vrasës, ziliqarë dhe egoistë.

- Pse i shan kaq shumë njerëzit? Unë i dua.

- T'i duaësh. Edhe unë i dua. Po nuk mjalton.

- Sa keq që do të ndahemi. Je shumë i bukur.

- Po qeshë unë shumë i bukur, edhe ti je shumë i bukur.

- Po unë nuk të kuptoj.

- Edhe unë nuk të kuptoj.

- Njerëzit janë të mirë. Babai dhe nëna ime janë të mirë. Edhe halla ime është e mirë.

- Engjëjt i duan njerëzit, po kjo nuk do të thotë që njerëzit janë të mirë.

- Nëna ime është shumë e mirë.

- Është shumë e mirë. Engjëlli i saj

mbrojtës është këtu, ka zbritur dhe ai...

- Halla është shumë e mirë.

- Edhe engjëlli i saj ka zbritur...

- Babai...

- Jo, jo, babai s'ka engjëll.

- Gjeji babait një engjëll të lutem, një engjëll që ta dojë... ti nuk e di se sa i mirë është babai... Do t'i gjesh?

- Nuk të premtoj, se ai është i pandreqshëm.

- Jo, jo, ai është i mirë, ndihmojeni babanë tim.

- Ç'ka të mirë ai?

- Po ai të bën për të qeshur, të bën shumë për të qeshur...

- Nuk mjafton.

- Është i dhëmbshur. Kur sëmurem unë, bën si i marrë, bërtet e shan kot, se i vjen keq. Thërret doktorin natën. Kur unë e pyes për ndonjë gjë, ai më përgjigjet, po asnjëherë nuk më thotë gjëra të sakta.

- Megjithatë, nuk të premtoj.

- Mos të vij keq, po ju engjëjt qenkeni zemërgur. Po si gjete babait një engjëll që ta mbrojë, unë do të allnohem me ty, s'do të flas më

me gojë.

- Nuk të premtoj. Tani, këtë çast ai shiti dhe dy zogj të tjerë. Ja u hodhi njerëzve të gjorë, tamam si një bataçji.

- Ku e shikon ti?

- Ne engjëjt i shikojmë të gjitha. Po ti mos u mërzit, unë do të përpiqem për babanë tënd. Të premtoj.

- Të dua shumë.

- Edhe unë të dua shumë. Përqafohemi dhe puthemi?

Ata të dy, djali dhe engjëlli u perqafuan dhe u puthën. Papritur engjëlli rrahu flatrat dhe, ashtu si ishin, të përqaftuar dhe të ngjitur me njëri-tjetrin, ungritën lart me një fluturim të ngadalshëm e përplot dritë në errësirën e natës.

- Ç'po ndodh kështu? - pyeti fëmija.

- Po fluturojmë - tha engjëlli.

- Jo, jo, të lutem, më zbrit poshtë në tokë se nuk ndahem dot nga halla, nëna dhe babai.

- Ti do dhe kur njeriu do, beson, dhe kur beson, një ditë bëhet edhe vetë engjëll.

U ndanë. Fëmija mbeti mbi parmak pranë qiriut që digjej me flakë të drejtë, kurse engjëlli u zhduk në errësirën e natës.

Djali hapi krahët, u ngrit mbi parmak me krahë të hapur priti të fluturonte, po asgjë nuk ndodhi. Mbylli sytë, lëvizi krahët dhe u hodh përpjetë, po sërish asgjë nuk ndodhi.

- Jo, - tha me zë, - s' dua të bëhem engjëll.
Baba! - thirri - Mama!

Po askush nuk iu përgjigj.

- Pse të bëhem engjëll!- tha - Mirë jam kështu si jam.

Djali doli në oborrin e kishës dhe atje pa fëmijë të veshur si ai, me po ato kostume që kishin po atë ngjyrë. Ata i ngjanin shumë. Të gjithë dukeshin të vetmuar dhe të hutuar.

- Kur do të na dalin flatrat? Po sikur një ditë të bëhemi engjëj dhe të fluturojmë? Jo, unë s' dua të fluturoj vetëm. Ta braktisim këtë tokë me policë që s' të lënë të shkosh në kishë? Pse s' të lënë të shkosh në kishë? Harrova të pyes engjëllin për policët e qiellit. Po edhe atje duhet të ketë policë engjëj. Po sikur të mos ketë? Akullore s'ka, as topa, as Anën që unë e dua, si do ta lë vetëm në shtëpinë e saj me qerpiçë, plot me hurma arbie dhe vishnje?

Sa beia e madhe, ku na doli dhe ky engjëll tani? Baba, mama!

Djalikaloi pranë kumbanores dhe qiparisave që shquheshin me spikamë në errësirë, pa ditur ç' të bënte dhe ku të shkonte.

- Mama, baba! - dëgjohej në errësirën e natës. Ishin shumë zëra të ndryshëm që kërkonin të rrejtat gjëra nëpër natën e përsëritur qysh nga fillimi i botës nën yjet dhe hënën që s'vdisnin si njeriu.

Fëmijët e veshur si ai dhe që i ngjasonin së tepërmi atij, kërkonin prindërit dhe s'i gjenin asgjekundi. Skërfyelli i gjatë dhe gruaja e bëshme i ndiqnin pas me duar të zgjatura sikur do t'i rrëmbenin.

Babai endej me zogun e fundit që e tundte në ajër. Sa keq baba, mendoi djali, ti s'ke engjëll. Tani që e pa babanë, iu duk e kotë ta takonte. Njeriu me fener ecte në ajër përmes avujve. Ai thërriste: bini në gjunjë, o mëkatarë dhe luani. Jezusi është duke ardhur bashkë me apostajt që e ndjekin nga pas. Qielli do të çahet më dysh dhe drita do t'i verbojë ata njerëz që s'do të bien në gjunjë duke u lutur dhe duke bërë kryq.

Halla lutej para ikonës. Qirinjtë e tretur digjeshin mbi mure gjysëm të rrëzuar, mbi çatinë e vidhisur të kishës, mbi gur, mbi bar, mbi degët

e pemëve, ndërsa njerëzit dergjeshin për tokë si hije, duke murmuritur lutje, me zë të mbytur e të *zwargur që vinte valë-valë jo nga kordat njerëzore, po nga nëndheu ku preheshin të vdekurit. Ishte një natë për të rriturit që vuajnë nga sëmundjet dhe ideja e vdekjes, po jo për fëmijet që kanë mundësi të fluturojnë lart bashkë me engjëjt.*

Për djalin ishte e gjatë dhe e frikshme ajo natë. Nuk po ndodhte thujtë asgjë. Qirinjtë digjeshin dhe njerëzit luteshin, ndërsa priftërinjtë vejevinin me zilka të vogla në duar që e rrënoqethnin natën nga pritja.

Fëmija fjeti dhe u zgjua, hëngri dhe u la, u vesh dhe u mbath, kaloi nëpër të njejtat vende ku njerëzit pritnin, ndjeu të rritej dhe t'i shqepëj kostumi të sqetullat, e në rrëzë të kofshëve, ndërkohë që nata s'mbaronte asnjëherë dhe mëngjesi s'vinte.

Pothuajse asgjë nuk konsumohej, çdo gjë ruhej, me ndryshime të vogla, që tregonin se, megjithatë, koha ecte. Diçka ndodhi lart në qiell, që fëmija s'e pa, por padyshim diçka ndodhi në mesin e natës që pësoi një lëkundje dhe nxorri një vrundullimë të mbytur.

Zilkat e priftërinjve u shpeshatuan dhe

tringëllimat e tyre e drejtuan llauzin si grigjë në majën e kodrës. Turma u ngjit atje lart dhe era që fryu, ua valëviti grave shamitë e kokës, shamitë e **JEZA QË BELAS MOREN ZJARR, PO T'U DOGJËN ISHTE NJË ZJARR I ÇUDITSHËM QË DIGJEJ VEUMEVEË, PO S' DIGJTE FARE, VEÇSE KRIJONTE FLAKËZA, DHE AURCOLA MBI KRYET E GRAVE. BURRAVE IU DOGJËN DUART. ATA I LËVIZNIN DHE IU FRYNIN, PO ZJARRI VAZHDONTE PUNËN E VET, PO VETËM DUKE LËSHUAR FLAKË.**

Djali pa se si iu dogjën këpucët... Ishte një flakë e kuqe në të kaltërt që t'i verbonte sytë.

Pastaj qielli llamburiti, sikur u hap papritur një dritare e madhe e padukshme dhe përmes erës që brambulliti, u shfaqën skeptri, një palë këmbë të zbathura, dy duart të thata me damar të kërcyer, mëngët e një kaftani të vjetër, të dalë boje e të grisur, gjersa më në fund doli fytyra, që s'e ka parë njeri por që e njohin të gjithë, ajo fytyrë e dashur, e dhembshur e të afërmit tonë, me sytë që të ngjallnin shpresën e topitur dhe besimin e humbur.

- Jezui - pëshpëritnin njerëzit. - Jezui, vërtet. Dhe mbetën ashtu gojëhapur e syshqyer duke ndjekur nëpër qiell kalimin e Jezuit. Ishte një kor engjëllor që e mbushi natën me zëra të

padëgjuar, me një melodi të parrëfyer, që njerëzit e kanë, po s' e dëgjojnë, e ndjejnë, po s' e shijojnë. Duke u dridhur, njerëzit, që shtrëngoheshin tek njëri-tjetri, shqyenin sytë të shikonin kush i lëshonte ato zëra, po e panjohura dhe misteri i natës i bënin vetëm të psherëtinin dhe kur e kur të qanin me ngashërim nga mirënjohja, se të gjithë e ndjenin veten nga pak, të shenjtëruar, si qenie të dyzuara, gjysëm perëndi. Secili filloi të pëshpëriste për hallin e vet, për sëmundjen a të fshehtë të torturuesë që po ia nxinte jetën, pak më vonë ajo pëshpërimë e ankthshme disi e drojtur dhe e turpshme, u shndërrua në vaj e klithmë, se aq u desh, prania e Jezuit në qiell tek i vështronte me një palë sy prej të afërmi që ata të gjithë të zbulonin të fshehtat munduese të jetës.

Ishte një katraurë e vërtetë; histori të llahtarshme që thuheshin me zë të lartë, thika të përgjakura, pika gjaku që u stërpiknin fytyrat, zinxhirë dhe pranga, hej të skuqur, vikama, britma, goditje, sharje, rropatje, grahma dhe asgjë më. Njerëzit binin në gjuhë, njëri pas tjetrit, të dërrmuar nga lodhja, dhe një shurdhëri e memecëri e akullt e tronditi natën.

Jezusi u ul në kodër dhe zgjati dorën

përpara mbi kryet e njerëzve. Pas tij në qiell u shfaqën apostujt me flokë të gjatë dhe me mjekra të zeza, me kaftanë dhe skeptër. Këmbët e z bathura shkenin nëpër erë me madhështi dhe magji. Ata qëndronin lart në formën e gjysëm rrethit me qirinj të mëdhenj nëpër duar. Për një çast asgjë nuk pipëtiu.

Djali dridhej nga të ftohtit. Halla doli përpara dhe i puthi këmbët Jezusit. Ajo qante, fërgëllonte e tëra sikur ta kishin zënë ethët.

- Ngrihu - foli Jezusi - përse vuani?

- Maria atë, Maria, ajo e lidhura atje kërkon të bëhet nënë e mirë.

- Ajo është nënë - tha Jezusi.

- Feneri do që t'i shikojë edhe një herë fëmijët dhe gruan.

- Do t'i shohë!

- Vëllau im Fjodori bën prapësira; pak më parë shiste zogj te beshiri në kishë duke i mashtruar njerëzit. Ai i gjori është shpirtnjeriu. po ka shejtanin në bark.

- Lutu për të...

Jezusi kaloi përpara i shtyrë nga turma e njerëzve që përpiqeshin të gjithë me një zë të rrefeshin të fshehtat, kurse halla mbeti pas duke u

lutur për të vëllanë.

- E lënë, - dëgjoj ajo pas shpinës së vet - po harrove hallin tënd moj e nxirë me bojë... pse s'i the s'e do një burrë me karafil në thilenë e xhaqetës?

- Më ler, Fjodor se po lutem për ty...

- Lutu sa të duash, po u bë ajo që mendon ti unë ia heq vetes. Po hahet gjella pa kripë, moj budallaçkë? Ti jeton me bukë e ujë, ashtu je mësuar, unë dua mish e verë...

- Ç' do të thuash me këto fjalë?

- S' dua të mbetem i virgjër de, po dua t' i provoj të gjitha zahiretë e kësaj bote... oj, i gënjen mendja se do të jetojë për jetë e mot... harrojnë të zinj të njerëz krimbin që do t' i përpijë nën tokë... jo po jetokan shpirtrat... një mut...

- Fjodor, të kam mallkuar! S' ke të bësih më me mua! Ti je mi gjirizi, pthu, jazëk të qoftë!
- shau halla të vëllanë, ndërsa ai iku duke qeshur.

- Baba! - thirri djali - T' i themi për një radio të re dhe për një palë raketa tenisi? Ç' thotë ai, bëhet.

- Kush, prifti?

- Jo prifti, baba, po Jezusi.

- Ç' flet, bir.

- Jezusi baba, nuk e shikon?

- Ju keni luajtur të gjithë... ti i ke ngjarë hallës, do të vuash tërë jetën nga vetvetja... O i ziu unë ç'më preu barku - tha babai dhe u ul pas një shkurreje.

- "Ai s'e ka parë Jezusin se është baba pa engjëll. Unë nuk do t'i them gjë, s'dua ta dëshpëroj babanë. Jezusi s'qenka për të gjithë..."

- Unë shikoj, unë shikoj - thirri Feneri dhe qau nga gëzimi. Ai u përkul përpara dhe bëri gjestet e një njeriu që përqafton dikë. Dy fëmijë të bukur të larë dhe të pastruar, të veshur me rroba të bardha u përqaftuan me Fenerin. Një grua e hollë dhe e gjatë me shami të zezë, me një buzëqeshje verbuese në fytyrë, duke marrë frymë me zor, u hodh dhe ajo mbi krahët e Fenerit.

Beretën me të shoqen i ndiqte pas një vargan prej 50-60 fëmijësh të kapur njëri pas tjetrit që këndonin me zëra ëngjëllorë.

Buka gatuante në një furrë diku në një qoshkë dhe fëmijët e tij luanin me bukë të rrumbullakëta si me topa të lehtë ajrorë. Kur hidheshin lart, topat merrnin ngjyrë të kaltërt në blu, bëheshin pa peshë dhe fluturonin ngadalë si ballonë.

Lemza kishte ngrirë në këmbë, i heshtur, i hutuar, pa lemezën e vet.

Maria vinte nëpër shtegun e fushëtirës, e veshur me të bardha me një kurorë manushaqesh mbi krye, në krahun e një djaloshi të gjatë me kaçurrela. Ai kishte sy të kaltërt dhe qeshte shumë ëmbël. Ndërsa Maria, si zonjë e madhe, ngrinte fustanin me fruda dhe zbulonte një palë këpucë platini. Edhe halla ishte veshur me të bardha, ajo ecte e krekosur, me bikutina në kokë, më një gjilpërë me fill të bardhë që zgjatej pa fund, të cilën e mbante me dy gishtërinjtë e mëdhenj. Në krah kishte një burrë me pamje inteligjente, të veshur me sqimë të madhe, me një kostum të zi dopio pete, në xhepin e vogël të të cilit dallohej maja e një shamije të bardhë.

.Halla dukej e kënaqur dhe për dhimbjen e hollë të fëmijës nuk ia varte më njeriu, as atij vetë, që e shoqëronte me ca sy të brengosur.

Megjithatë fëmija ndihej si në lojë dhe si në përrallë. Iu kujtua Ana, ajo vajza me bishtaleca, të cilës një mëngjes ai i kishte ngrënë një copë mollë në vendin ku dukeshin shenjat e dhëmbëve të saj. Në shtëpi bënte naze, thuajse nuk hante dhe të gjella, pjata piruni e luga, i dukej se gjente

gjithmonë papastërti. Sa e donte Anën. I vinte të qante me ngashërim. Kishte një peshë përbrenda dhe i dukej sikur do t'i binte të fikët.

Babai mblidhte rigon dhe i fuste në çantën bosh të zogjve të teleshirit. Nëna qante në varrezë. Për kë qante ajo?

Kisha s'ishte më ajo e para, por një katedrale që vezullonte nëpër natë. Ah, Ana, Ana, të ishe dhe ti sonte këtu. Ç' do të bëja? Asgjë, pothuaj asgjë. Ti do t'ia bëje ua, ua, nga habia dhe mrekullia. Pastaj unë do të puthja, në buzët që t'i zakonisht i lag me gjuhë. Ah, Ana, Ana!

Titi, tashmë një djalosh i bukur dhe i qetë lexonte poezi duke ecur në një livadh me margarita dhe ketra. Poezia fliste për shtegun e fushës me cingërrimë të kaltër, për mejhanet dhe korat ruse. Pastaj ai përmendi emrin e një vajze, të Ana Snjeginës, me kaq dhimbje e pikëllim sa hëna ra e u mbyt në pellgun e fushës. Ajo u platit atje, e verdhë si limoni, në mes të pasqyrimit të drithshëm të qirinjve që digjeshin kudo nëpër natë me flakë të luhatura.

Ah, Ana, Ana, një puthje nën drurë, vetëm një puthje nën drurë, pastaj thërrasim engjëjt dhe

ikim të qetë nga kjo botë që ubë për të gjithë. Vetëm atëherë Anë, vetëm atëherë mund të ikim, kur bota të bëhet për të gjithë.

Dikush qau me një zë të llahtarshëm. Djali sikur u përmend nga një vegim, ktheu kokën dhe pa në mes të oborrit të kishës tre kuaj të mëdhenj të zinj që u ndrinte qimja, duke çukërrmuar patkonjtë mbi gurët e lëmuar. Kalorësit, ishin veshur me hekur. Ai i njohu dhe u drodh nga frika.

- Kush e ka lidhur Marien? - foli njëri prej tyre me zë të mbytur prapa hekurave. Ishte një zë i frikshëm dhe fëmija s'kish se si të mos lagej.

- Urata - u përgjigj dikush.

- Kush e rrahu?

- Urata.

- Urata të vijë këtu.

Pllakosi heshtja. U dëgjua një zhurmë banale, që të bënte për të qeshur, por asnjë nuk qeshi. Ishte babai pas një ferre që ia bënte, obobo, i ziu unë...

- Urata të vijë këtu, thashë - u dëgjua sërish zëri pas hekurave.

Urata erdhi. Nga nxitimi i kishte rënë kësula rrugës.

- Në hu!

- Në hu! - pëshpëriti turma.

Dy flakëhedhës dogjën drurët e një zabeli. Atje mbi një hu të përcëlluar tek lëshonte ende tym, e ngulën uratën që s'nxorri fare zë.

Pas pak midis turmës u duk Maria me trupin e përgjakur, që mbante në dorë një shkop.

- Unë e rraha vetë trupin tim. Jam mëkatare.

- Të gjithë jeni mëkatarë. Të gjithë do të nguleni në hunj. Të gjithë, edhe gratë që presin të lindin, edhe fëmijët, edhe morrat tuaj... pastaj do t'ju djegim dhe në hirin tuaj do të mbijnë hunj për të tjerë kafshë të pabindura e të mallkuara si ju. Nuk ka Zot...

- Zot ka! - tha Maria. - Jezusi është këtu.

- Në hu!

Huri hyri në seksin e saj dhe i doli tek goja që iu çka deri në rrëzë të veshëve. Gjaku rrodhi me vrull dhe një vijë e hollë shkau poshtë barqeve të kuajve, që pikonin, kaloi përmes kishës dhe mori udhën përpjetë kodrës për në varreza.

- Ç' bëni kështu more katilë! Ju ndëshkoftë perëndia! Mallkimi brenda në qishë zë... Do ju

sëmuren fëmija, do ju vdesin para syve duke u përpëlitur - uluriu halla.

- Merreni!

Dy policë e tërhoqën hallën zvarrë nëpër plloçat e oborrit...

- Pazhallusta! - thirri Titi lakuriq vetëm në brekë. Ai ia hoqi hallën policëve nga duart dhe i qëlloi me gurë. Kaq donte turma, dhe nga zhurma që bënin gurët mbi hekur, vendi përreth i ngjau një kovaçane. Por kjo nuk zgjati shumë, se kalorësit vunë në përdorim flakëhedhësit dhe i pari që u dogj ishte Titi, i cili edhe pse përpëltej i përfshirë nga flakët e mëdha, vazhdonte të mbante fjalime rasisht. Marigoja e përqafoi të birin me një ulurimë të llahtarshme dhe sakaq mbaruan të dy, ndërsa turma rendte nga sytë këmbët dhe flakëhedhësat që i ndiqnin, digjinin e shkrumbonin ç'kish mbetur prej tyre, ikona, bohçe me ushqime, rroba, pjata, lugë, pirunj, zogj te beshiri...

Dhe pastaj erdhi mëngjesi.

Udha i ngjante një shkretëtire, si fundit të botës.

Turma ecte e shpërndarë dhe qante me kuje.

Kalorësit rendnin atje poshtë buzë detit.
Dhe në fillim ishte fëmija. Ai tarrri dhe
ngriti duart lart.

- Engjëlli, hallë, engjëlli!

Halla ilëmoi flokët e verdhë dhe i vuri
dorën në balë.

- Digjesh nga ethet, shpirtkë.

- Hallë, ai na i bën me dorë që ta ndjekim.

Dhe fëmija u kthye mbrapsht andej nga
kishin ardhur.

- Ata i dogjën të gjitha, s'lanë gjë më
këmbë - tha halla, - Edhe Jezusin e dogjën... Jo,
në këtë vend s' mbin më bari...

Fëmija shikonte engjëllin e vet që ia
bënte me shenjë ta ndiqte. Vetëm kur u dëgjua
korr, ai korr i kishës, krejt i padukshëm me zëra
engjëllorë e prekës, turma u kthye dhe u ngjit
sërish në kodër.

Atje, mbi rrënojat e kufomat, mbi qirinjtë
që digjeshin ende, fluturonin korbat dhe endeshin
dy hajdutët.

Tetor 1993

F u n d



Roland

2039

KY ROMAN U SHKRUVA PËR VETËN
ATY KA NJË TURMË NDERË-
ZISH, JEZU KRISHTI, NATË,
NGA FILLIMI DERI NË FUND,
NJË FEMIJE DHE NATYRISHT
NJË APOKALIPS. AI FEMI-
JE ËSHTE VETË ROLANDI,
QE IU PARAQIT MUNDËSIA
PËR FLUTURIM, PONUK
FLUTURO!...